



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
“Shkenca Islame”  
Kolegji Universitar “Bedër”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Enri Hide**

**Dr. Zana Strazimiri**

**Tetor/ 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në Shkenca Islame**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar 'Bedër'
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Islame
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: "Shkenca Islame"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr 247 datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 14 PAE / 4 PAK 2022-2023 15 PAE / 4 PAK 2023-2024 13 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 10 studentë; 2022-2023 7 studentë; 2023-2024 10 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Shkenca Islame” organizohet nga Departamenti i Shkencave Islame, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”. Kolegji Universitar “Bedër” ka dy Fakultete;

1. Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit;

Programi akademik është i riorganizuar nga gjuha turke në atë angleze, duke filluar nga viti akademik 2021-2022 dhe ky proces akreditimi i tij zhvillohet për herë të parë.

Ky program i ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Islame” është tre vjecar, me formë studimi me kohë të plotë dhe me 180 ECTS. Në përfundim të tij, lëshohet diploma “Bachelor” në “Shkenca Islame”.

Departamenti i Shkencave Islame vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore dhe kontribuon në zhvillimin e studimeve, kërkimit shkencor dhe formimit të të rinjve profesionistë në fushën e Shkencave Islame. Që nga krijimi i tij, institucioni ka synuar dhe synon në vazhdimësi t'i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojës për arsimimin e përgatitjen e kuadrove fetarë, në përputhje me misionin e përgjithshëm të KUB dhe standardet ndërkombëtare si edhe duke ndjekur zhvillimet e risitë në fushën e edukimit fetar në vend e më gjerë, brenda vizionit e specifikës së tij.

Me strukturën e përmbajtjen e tij, si një program unik në fushën e Studimeve Islame, programi i ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Islame” i përgjigjet nevojës për të formuar individë me aftësi, shprehi, kompetenca e horizont intelektual në njohjen, vlerësimin dhe interpretimin e burimeve klasike dhe bashkëkohore të Shkencave Islame, që ndjekin nevojat dhe ecurinë e informacionit e problematikave në këtë fushë, bashkëpunues dhe të integruar në shoqëri, duke gërshetuar traditën, kulturën dhe realitetin bashkëkohor me vlerat perendimore, në përputhje me zhvillimet aktuale.

Synim formues dhe edukativ i programit është promovimi i vlerave morale, fetare dhe , për të formuar profesionistë e qytetarë aktivë, të moralshëm dhe inovativë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL, në përputhje me dispozitat ligjore e nën ligjore.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. GVJ, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin “Bachelor” në “Shkenca Islame”, pranë Departamentit të Shkencave Islame të KU “Beder”, ne dokumentacionin shoqërues të raportit dhe në vizitën dy ditore organizuar pranë këtij institucioni më 5.03.2024 dhe 6.03.2024. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

ASCAL, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KUB, për të realizuar vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka në përbërje: **Prof. Asoc. Enri Hide** dhe **Dr. Zana Strazimiri**. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ky grup pune u asistua nga përfaqëuesja e ASCAL Anilda Beqiraj.

Gjatë vizitës në KU “Beder”, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Islame” nën vlerësim, me anëtarët e departamentit, përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale, si të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, Bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga përfaqësuesja e ASCAL, e cila ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumentave dhe vënien e tyre në dispozicion të GVJ.

**Kolegji Universitar “ Bedër”, është njohur me DRVJ më datë 01.10.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 101/10 Prot date 01.10.2024. Kolegji nuk ka komente . Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.**

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Islame”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Misioni i KU “Beder” është funksionimi si një institucion elitari i arsimit të lartë për shqiptarë e të huaj, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qëndër rajonale e arsimit të lartë e kërkimit shkencor. Qëllimi i tij është të përgatisë individëve të kualifikuar për realizimin në praktikë të ideve e projekteve që i shërbejnë progresit shoqëror e interesave të vendit. Me programet e studimit që ofron, institucioni kontribuon në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” ofrohet në shërbim të interesave kombëtare, i bazuar në statutin e institucionit, ku paraqitet vizioni për të kontribuar për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, nëpërmjet realizimit të një procesi cilësor edukimi. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore konsiderohen si baza e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, ndërthurur me standartet dhe arritjet më të mira ndërkombëtare. Nëpërmjet edukimit dhe forcimit të vetëdijes humane, fetare, kombëtare, kulturore, etike dhe identitare të studentit, programi reflekton interesat dhe përparësitë kombëtare të vendit për edukimin e tolerancës dhe bashkëekzistencës fetare, frymës së mirekuptimit fetar e kulturor, harmonisë e bashkëjetesës paqësore në shoqëri.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.8: Plani Strategjik Institucional 2024-2028]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sylabuseve të lëndëve e nga takimi me stafin akademik të programit “Bachelor” në “Shkenca Islame”, rezulton se programi, i cili ofrohet në anglisht, është në përputhje me objektivat dhe misionin e Kolegjit Universitar “Beder”, për të promovuar një kuptim të drejtë të shkencave bazë të fesë islame, kulturës dhe qytetërimit islam si dhe për të nxitur mirëkuptimin reciprok midis</p>

	<p>shtresave të ndryshme të shoqërisë. Në përgjithësi, programi i shërben formimit të specialistit të fushës, duke edukuar aftësitë e leximit dhe perceptimit të dijes islame e burimeve themelore të studimeve islame, bazuar në njohjen e nevojave dhe informacionit në këtë fushë, por edhe duke kultivuar tek studentet shprehi e cilësi etike, estetike, kulturore dhe profesionale, në kontekstin e qëllimeve dhe misionit të institucionit. Me kurrikulën e tij, programi i kontribuon përhapjes së mesazhit paqësor të Islamit në rajon e më gjerë.</p> <p><b>[Minutat e Vizitës; Ev.2: Statuti i KU “Beder”; RVB; Ev.19: Sylabusët e lëndëve të programit]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” konstatohet se ky i fundit ofrohet në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit, Rregullores e fushave akademike të institucionit.</p> <p>Në përputhje me statutin e rregulloren e institucionit, me mision përgatitjen, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, e individëve të kualifikuar e me standarte të larta e nivel bashkëkohor, programi ka në objektivat e tij arsimimin dhe edukimin e thelluar në fushën përkatëse të shkencave islame, realizimin e një profili të ri të teologu në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomike, politike dhe shoqërore të realitetit aktual. Programi i përgjigjet alternativave konkrete për zhvillimin e fesë në Shqipëri e krijimin e një elite të re të teologëve të fesë islame. Nga ana tjetër, në përputhje me planin strategjik institucional, programi synon të përgatisë jo vetëm të diplomuar të suksesshëm e me aftësi të thella profesionale, ekspertë që përmbushin kërkesat e tregut të punës, por edhe individë me cilësi të larta morale dhe shoqërore, që shërbejnë si modele frymëzues dhe motivues në shoqëri.</p> <p><b>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.8: Plani Strategjik Institucional 2024-2028; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Islame, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me përvojë në mësimdhënie si dhe me burimet e kapacitetet e duhura akademike për zhvillimin e tij, bazuar kjo mbi të dhënat e sjella nga vetë institucioni. Ai është i vetmi program i këtij lloji në vend.</p>






<p>programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga biseda me Dekanin e përgjegjës të Departamentit, konstatohet se njësisia bazë e “Shkencave Islame” pranë FShHD ka në përbërje të stafit akademik profesorë, lektorë dhe asistentë-lektorë me përvojë, të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ata kontribuojnë në procesin e mësimdhënies të profilizuar sipas lëndës që zhvillojnë, duke patur përvoja të vlefshme si autorë tekstesh mësimore, monografish e punimesh shkencore, por edhe si komentues, vlerësues apo përkthyes të veprave fetare.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezultojnë përpjekja e institucionit në drejtim të aftësimin e kualifikimit shkencor të stafit, me një bilanc të konsiderueshëm aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, seminare, trajnime e specializime, botime shkencore, këto të fundit të botuara në revista të ndryshme akademike si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj , e pjesëmarrje në projekte kërkimore. Institucioni ka përcaktuar si objektiv strategjik të tij mbështetjen e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës, Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.8: Plani Strategjik i KU “Beder” 2024-2028;Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Misioni dhe vizioni i Departamentit kanë shërbyer si bazë e ngritjes së objektivave të programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” në gjuhën angleze.</p> <p>KUB është i vetmi institucion në Shqipëri që ofron një program të tillë studimi të ciklit të parë “Bachelor”, së bashku me programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, që u hapën varësisht nevojave të paraqitura nga Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH) për specialistë dhe kuadro me arsim të lartë në nivel kombëtar, rajon e më gjerë.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”, i hartuar në përputhje me misionin dhe vizionin e KUB, bazohet në kërkesat aktuale të shoqërisë shqiptare dhe përtej, në nevojat e tregut të punës si edhe zhvillimet e pritshme të arsimit, kulturës, mirëqenies shpirtërore dhe ekonomisë. Ai është në përshtatje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane për ta konsideruar e trajtuar çështjen e identitetit fetar si element që i kontribuon paqësisht forcimit të shoqërisë shqiptare në zhvillimin e qëndrueshëm, në funksion të integritetit në BE e të bashkëpunimit pozitiv në rajon e më gjerë.</p>




	<p>Nga vizita në institucion e GVJ dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, programit e syllabuseve të lëndëve, konkludohet se programi i studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”, si përsa i përket fushës së përgjithshme, ashtu edhe asaj specifike, është ndërtuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njëjse mësimore e kërkimore që e ofron atë, Departamentit të Shkencave Islame, në mbështetje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</p> <p><b>[Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.8: Plani Strategjik i KU “Beder” 2024-2028; Ev.19: Syllabuset e lëndëve të programit]</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, i syllabuseve të lëndëve e nga takimi me stafin akademik te programit “Bachelor” në “Shkenca Islame”, rezulton se programi ofrohet në shërbim të interesave kombëtare dhe strategjisë për zhvillim si dhe në përputhje me objektivat e misionin e Kolegjit Universitar “Bedër, në zbatim të statutit, rregullores dhe fushave akademike të institucionit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njëjseve e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit e njëjse kryesore e asaj bazë si dhe përfaqësuesit e zyrave menaxheriale të institucionit, bazuar edhe në shqyrtimin e dokumentacionit, konstatohet se programi “Bachelor” në “Shkenca Islame” realizohet në kushtet e ndarjes së detyrave e përgjegjësiwe mes njëjseve dhe personelit. Rregullorja e institucionit e aktet e brendshme dispijlojnë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, duke përcaktuar rolet e përgjegjësitë përkatëse të personelit akademik, ndihmës-mësimor e administrativ në nivel bashkëpunimi e koordinimi dhe në përputhje e në shërbim të programit të studimit. Njësia bazë, që mban peshën kryesore</p>



<p>vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>për mbarëvajtjen e programit, monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e mbarëvajtjen e programit, nëpërmjet analizave periodike, formave e metodave vlerësuese e vetëvlerësuese.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë mësimore; Ev.28: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës të institucionit rezulton se, në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KU “Beder” u ka kushtuar rëndësi të veçantë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit e aktorëve të tjerë të interesuar. Institucioni ka ndjekur politikën e promovimit të raporteve bashkëpunuese në shumë nivele dhe të lëvizshmërisë së personelit akademik e studentëve.</p> <p>Gjithashtu, me këto marrëveshje është synuar t’u mundësohet studentëve zhvillimi i praktikave profesionale me perspektivë edhe punësimi; bëhet fjalë për institucionet në varësi të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si myftini, medrese, kurse dhe qendra kulturore në Shqipëri dhe diasporë, etj, që u sigurojnë studentëve një përvojë të rëndësishme për aplikimin e studimeve të tyre teorike gjatë formimit universitar. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione e universitete homologe në një sërë vendesh si Austri, Itali, Egjipt, Turqi etj kanë inkurajuar shkëmbimin e ideve dhe përvojave në fushën e mësimdhënies e atë kërkimore-shkencore, organizimin e konferencave ndërkombëtare e projekteve të përbashkëta kërkimore si dhe realizimin e programeve trajnuese e shkollave verore në bashkëpunim me një numër universitetesh të huaja me reputacion në fushën akademike ndërkombëtare në Studimet Islame.</p> <p><i>[Ev. 4: RVJ; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.24: Studim tregu i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.74: Lista e institucioneve me të cilat KUB ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunim]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit,</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga bisedat me drejtuesit e institucionit, rezulton se KU “Beder” ka nënshkruar</p>




<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>marrëveshje të posaçme me institucione të ndryshme, duke u dhënë mundësi studentëve jo vetëm të zhvillojnë praktikat profesionale, por të krijojnë dhe ura lidhëse me tregun e punës; një pjesë e mirë e tyre punësohen në institucionet ku kanë zhvilluar praktikën. Institucioni, nëpërmjet marrëveshjeve, garanton edhe procesin mbikqyrës të praktikës nga ana e punëdhënësve. Nga biseda e GVJ me studentët e programit “Bachelor” në “Shkenca Islame” u evidentua predispozicioni i departamentit për të realizuar praktikat në institucionet me të cilat ka marrëveshje, bazuar në kërkesat e studentëve, veçanërisht atyre të huaj, që lidhen me nevojat dhe perspektivat e profilizimit e të punësimit të tyre në vendet nga vinë.</p> <p><i>[Minutat e vizitës, Ev.38: Lista me marreveshjet e bashkëpunimit per realizimin e praktikave profesionale; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.60: Lista e institucioneve me të cilat KU “Beder” ka marrëveshjeve partneriteti per bashkëpunime në fusha të ndryshme]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame harton në mënyrë periodike raporte, siç janë ato vjetore, që i referohen analizës së ecurisë së programeve të studimit me indikatorët përkatës, duke evidentuar edhe realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në analizën përkatëse SWOT evidentohen pikat e forta e te dobta të punës në departament, problematikat dhe drejtimet e përmirësimit të veprimtarisë mësimore e shkencore si dhe të perspektivës e efikasitetit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programeve të studimit.</p> <p><i>[RVB; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se KU “Beder” u ka kushtuar rëndësi të vecantë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda e jashtë vendit e aktorë të tjerë të interesuar, në funksion të realizimit të programit të studimit, aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit e studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Programi i studimit organizohet dhe zgjat tre vite studimi dhe me 180 ECTS në total. Në planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose</p>	<p>Programi i studimit në Bachelor në: “Shkenca Islame” synon formimin e studentëve në fushën e shkencave islame, duke ofruar njohuri të avancuara, aftësi dhe kompetenca të thelluara për t’i përgatitur ata për të kontribuar në strukturat e KMSH-së, Medreseve, Këshillit Ndërfetar, etj. Kjo është një qasje pozitive për zhvillimin e njohurive të avancuara mbi fushën e shkencave islame dhe doktrinat tradicionale në kontekstin shqiptar dhe rajonal.</p> <p><i>[Evidenca nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale]</i></p>

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program ka bërë një ndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmbyllëse, duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore, si edhe kreditet përkatëse për çdo lëndë. Kjo shpërndarje është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programet specifike të çdo lënde janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr. 2 të VKM nr. 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit <i>neni 16</i>, lëndët jepen në kredite dhe të grupuara sipas veprimtarisë formuese në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) A: 19% ose 35 ECTS;</li> <li>- Lëndë karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore) B: 52% ose 94 ECTS;</li> <li>- Lëndë ndër-disiplinore/integruese C: 14% ose 25 ECTS;</li> <li>- Lëndë plotësuese D (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktikë profesionale): 12% ose 20 ECTS;</li> <li>- Detyrim përmbyllës E: 3% ose 6 ECTS;</li> </ul> <p><i>[Evidenca nr. 56 Udhëzim nr.15, dt. 04.04.2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë]</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sa i takon praktikës profesionale, ky program studimi nuk e parashikon në programin mësimor. Punimi i diplomës është parashikuar si detyrime përmbyllëse me 6 kredite ECTS në kategorinë “E”. Duke përbërë 3.33 % të peshës totale të programit. Megjithatë, nga takimet në institucion dhe diskutimet me studentët, stafin dhe drejtuesit e departamentit e të fakultetit, rezultoi se janë ngritur disa mekanizma për</p>




	angazhimin e studentëve në praktika brenda vetë institucionit KUB, institucioneve partnere dhe organizatave jo-fitimprurëse.  <i>[Evidenca nr. 41 Rregullorja e Praktikës Profesionale]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Organizimi i studimeve është në përputhje me Udhëzimin përkatës Nr. 15 (04.04.2008). Studenti duhet të marrë nr. e caktuar të krediteve, duhet të konsiderohet kalues në lëndët përkatëse dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në ligj, udhëzimin e sipërpërmendur dhe në udhëzimet e dhëna nga Senati Akademik i institucionit.  <i>[Evidenca nr. 56 Udhëzim nr.15, dt. 04.04.2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky kriter nuk aplikohet pasi nuk ka programe të tjera Bachelor që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, në institucione të tjera.
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	KU “Bedër” ka kryer kodifikimin e programit në bazë të vendimit nr. 310, datë 11.5.2022 “Për Specifikimet Dhe Përmbajtjen E Kodifikimit Të Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Respektivisht (72MS 0221A).  <b>[Evidenca: RVB]</b>
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet. Ky program studimi nuk ka programe të përbashkëta midis ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë.
<b>Konkluzione</b>	<i>Programet janë të organizuara në lëndë dhe module. Veprimtaritë formuese janë të specifikuara qartë në program.</i>



	<i>Kriteret ligjore për funksionimin e njësisë bazë janë respektuar, si dhe është përcaktuar Kodi Përkatës i Programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>									
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>									
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>								
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër”, ka dy njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë;</li> <li>2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit;</li> </ol> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë përbëhet nga 4 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>2. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze;</li> <li>3. <b>Departamenti i Shkencave Islame;</b></li> <li>4. Departamenti i Shkencave të Komunikimit;</li> </ol> <p>Programi i ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Shkenca Islame” organizohet nga Departamenti i Shkencave Islame. Të gjitha programet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë janë të miratuara me VKM 286/2011 dhe të akredituara.</p> <p>Në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë për vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët paraqiten në Aneks, <i>Tabelat Përmbledhëse, tabela 1</i>, me kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="608 1845 1347 1948"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë		PAE	PAK			
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë								
	PAE	PAK							



Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc	4	2
Dr/PhD	12	6
Msc	21	12
<b>Gjithsej</b>	<b>38</b>	<b>21</b>

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Shkencave Islame, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	1	-	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	2	2	1	1	2	-
Msc.	7	2	8	2	7	3
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>11</b>	<b>4</b>	<b>11</b>	<b>3</b>

*[Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë]*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Njësia bazë angazhon personel ndihmës akademik/administrative për praktikat mësimore, në rastet kur kjo është konsideruar e nevojshme. Referuar RVB dhe *Aneks, Tabelat Përmbledhëse tab 1*, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka të punësuar 1 personel ndihmës- akademik, i cili mbështet stafin akademik dhe studentët gjatë realizimit të proceseve akademike.

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është

Departamenti ka përcaktuar qartë në rregulloren e studimeve (*Neni 10*) ekzistencën/emërimin e një koordinatori të programit të studimit. Ky është një funksion që i ngarkohet automatikisht përgjegjësit të departamentit. Koordinator i Programit të studimit ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve.

përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<b>[Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Verifikohet angazhimi i personelit ndihmës në praktikat mësimore si dhe është përcaktuar një coordinator për programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga vërejtja e RVB-së dhe vizita në institucion e GVJ-së dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, konstatohet se Njësia Bazë (Departamenti i Shkencave Islame) disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Kjo reflektohet edhe pasqyrimi i këtyre informacioneve në mënyrën e organizimit dhe strukturimit të Njesisë Bazë. Këto informacione pasqyrohen në dokumentet e KUB-së, si Plani Strategjik, Statuti, Rregullet e Fakultet, Programi, Sekretarisë Mësimore  <i>[Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër. Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame përmban të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Programi i studimit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Shkenca Islame, organizohet me jo më pak së 180 kredite europiane (ECTS) me kohëzgjatje tre vjecare. Orët totale në auditor për Programin e studimit

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bachelor në Shkenca Islame janë 1658 orë leksion, dhe 42 orë për detyrimet përmbyllëse, në një total prej 1700 orë.  <b>Aneks tabelat e RVB, tabela 13;</b>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban kriteret e qarta të pranimit dhe regjistrimit të studentëve si dhe i ofron këto informacione në mënyrë transparente në kanale të shumëfishta komunikimi.  <i>Neni 5</i> në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Shkenca Islame, jep kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë i jep mundësinë çdo kandidati që ka përfunduar me sukses arsimin e mesëm. Kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës në masën 30%. Kandidatët që aplikojnë për pranim në programet që zhvillohen në gjuhë të huaj duhet të kenë marrë një ndër provimet e caktuara nga senati dhe të dorëzojnë certifikatën përkatëse.  <i>Neni 9</i> i rregullores jep procedurën e transferimit, ku departamenti ngre një komision që vendos për transferimet. Komisioni kryen të gjitha procedurat për ekuivalentimin e lëndëve për programet e ciklit të parë.  <b>[Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame]</b>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Ky program studimi përmban të gjitha informacionet e nevojshme për programet lëndore (silabuset) për çdo lëndë. Ato kanë të gjitha komponentët e nevojshëm, si info mbi pedagogun e lëndës, përmbledhjen, specifikat, temat, literaturën, kontrollin e dijeve, etj. Këto u verifikuan nga vëzhgimi i silabuseve të hedhura në sistemin online të ASCAL-it dhe të vëna në dispozicion gjatë vizitës së GVJ në institucion. Të gjithë këto elemente janë në përputhje me formatet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.  <b>[Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit; Minutat e takimit të GVJ]</b>
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet	Departamenti ka themeluar një praktikë të përvitshme, në çdo fillim viti akademik për rishikimin dhe përditësimin e programit dhe silabuseve. Propozimet vijnë nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i njësisë bazë.




eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.									
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant.</i></p> <p><i>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kreditet dhe dokumentacionin e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i></p> <p><i>Programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
			X						

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Mënyra e organizimit të silabuseve, emërtimi, ndërthurja mes tyre dhe plotësimi i dijeve nëpërmjet lëndëve që pasojnë natyrshëm njëra-tjetrën në semestra dhe vite akademike të njëpasnjëshëm, tregojnë se studentët mund t'i thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi fusha të ndryshme të Shkencave Islame. Nga analiza e kryqëzuar e silabuseve me programet më të avancuara perëndimore, rezulton një përputhshmëri e kënaqshme me fushat më të avancuara të dijes teologjike. Gjithashtu shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike, si dhe ndërthurja e saj, u mundësojnë studentëve kapërcim të lehtë drejt një tregu të ndërlikuar pune dhe shumë specifik, si ai i studimeve teologjike e konkretisht shkencave islame.
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Lëndët e Programit janë të shpërndara në vite dhe semestra, kanë një ngarkesë harmonike mes veprimtarive formuese dhe veprimtarive të tjera. Mësimi në auditor (leksione, seminare, punë individuale) kombinohet me forma të kontrollit të vazhdueshëm të dijes. Referuar planit mësimor që paraqiti institucioni rëndësi e veçantë i kushtohet përgatitjes praktike profesionale të studentëve, nëpërmjet aplikimit të praktikave profesionale, stazheve, detyrave dhe projekteve me karakter



<p>rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>praktik, pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që kanë për qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit, vëzhgimit dhe zbatimit në praktikë të koncepteve dhe teorive të mësuara në auditor me qëllim përvetësimin më të mirë të tyre.</p> <p><i>[Tabela Nr. 10]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi ka një ndarje proporcionale midis formimit teorik dhe praktik. Shpërndarja e tyre është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme): 19% ose 35 ECTS</li> <li>- Lëndë karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore): 52% ose 94 ECTS</li> <li>- Lëndë ndër-disiplinore/integruese: 14% ose 25 ECTS</li> <li>- Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktikë profesionale): 12% ose 20 ECTS</li> <li>- Detyrim përmblyllës: 3% ose 6 ECTS</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabusi është programi i lëndës në të cilin parashikohen objektivat e përgjithshme të lëndës, literatura e detyrueshme dhe e sygjerruar, temat, orët e leksioneve dhe seminareve, kohëzgjatja e zhvillimit të lëndës, ngarkesa në kredite që ka lënda, format e kontrollit të dijes, titullarin e lëndës, etj.</p> <p>Përditësimi i silabuseve bëhet në bazë semestrale dhe vjetore, sipas kohës kur zhvillohet lënda. Pedagogët e përditësojnë programin dhe e dorëzon pranë koordinatorit të departamentit. Përgjegjësi i departamentit mbikëqyr procesin e përditësimit dhe sidomos të literaturës më të fundit.</p> <p><i>[Evidenca nr. 35 Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit kontribuon në ndërthurjen e elementëve praktikë me ato teorikë, jo vetëm duke ofruar dije në fushat teologjike të shkencave islame, por edhe duke i konsoliduar këto dije përmes zbatimeve praktike. Jo vetëm emërtimi, por sidomos përmbajtja e lëndëve, siç rezultojn nga</p>

	këqyrja e silabuseve, ka një ndërthurje të dijeve praktike dhe teorike, ku edhe kërkimi shkencor zë një vend të qartë, pavarësisht nivelit Bachelor të studimeve.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Studentëve u ofrohen njohuri themelore dhe specifike në këtë fushë. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studenti një bazë për vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e shkencave islame.</i></p> <p><i>Programi i studimit Bachelor Shkenca Islame zhvillohet në tre vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh Europiane prej 180 ECTS. Cdo vit akademik ka 60 kredite ECTS.</i></p> <p><i>Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</i></p> <p><i>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse	Bazuar në evidencat e dorëzuara nga institucioni ( <b>Ev. 38</b> ) Departamenti ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë nga një tërësi aktorësh, si institucione shtetërore, private, entitete jo-qeveritare, universitete, etj. Gjithashtu institucioni ka ngritur praktika të mira të këshillimit me këta aktorë partnerë përmes takimeve ët rregullta, konferencave, simpoziumeve, ditëve të caktuara, etj. Këtyre u shtohen edhe përpjekjet për të



<p>konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>përmirësuar përmbajtjen e programit, përmes këshillimit të targetuar, me insticione specifike.</p> <p><i>[Evidenca nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale]</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët aktualë gjithashtu janë pjesë e këtij procesi, duke përcjellë mendimin dhe vlerësimin e grupit mbi programin dhe lëndët specifike. Gjithashtu, pjesëmarrja aktive në anketën, që realizohet për çdo lëndë në përfundim të semestrit është një mënyrë tjetër sesi studentët ndikojnë në përmirësimin e programit. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh si dhe institucione publike e private në fushën e studimit të gjuhës angleze. Një praktikë e konsoliduar e departamentit është përditësimi i silabuseve. Politika e përmirësimit dhe përditësimit të programeve të studimit parashikon përfshirjen e bashkëpunëtorëve të ndryshëm në këtë proces. Kjo vërtetohet nga takimet periodike që ka organizuar Departamenti.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti është konsultuar dhe ka marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</i></p> <p><i>Departamenti ka përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur programin e studimit në përputhje me propozimet nga rrjetet e bashkëpunëtorëve. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Të gjitha format që përdor institucioni dhe konkretisht Departamenti për mësimdhënie e mësimnxënie, janë të parashikuara në rregullore dhe statutin e tij. Ato përfshijnë leksionet, seminarët, praktikat mësimore, praktikat profesionale, provimet e ndërmjetme, përfundimtare, detyrat e kursit, apo forma <i>ad hoc</i> të vlerësimit sipas specifikave të lëndëve ose modulit. Departamenti zbaton gjithashtu politikën e orëve të hapura, në mënyrë periodike, javore ose mujore, sipas një kalendari të dakordësuar paraprakisht. Përveç këtyre, departamenti dhe institucioni kanë organizuar konferenca, trajnime, leksione të hapura dhe seminare me ekspertë të fushës në baza periodike.</p> <p><i>[Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame</i></p> <p><i>Evidenca nr. 29 Mobiliteti i stafit dhe studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni përditëson rregullisht format e reja të mësimdhënies duke i përshtatur ato me nevojat e studentëve. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies për tju përgjigjur nevojave të studentëve dhe mësimdhënies në përgjithësi. Format e metodat e mësimdhënies ju bëhen të ditura studentëve me anë të syllabusve. Në syllabuse pasqyrohen larmia e metodologjisë së përdorur si leksionet me anë të të cilave studentët marrin njohuri teorike të cilat i vënë në praktikë apo krahasojnë praktikat në lidhje me to në orët e diskutimeve dhe detyrave të kursit. Personeli akademik</p>

	<p>përcakton orët e konsultimeve për studentët në mënyrë që të diskutojnë çështje apo probleme të paqarta.</p> <p><i>[Evidenca nr. 32 Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit</i></p> <p><i>Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Beder 2024-2028]</i></p>														
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për të kryer veprimtarinë e tyre në funksion të studentëve është shumë e rëndësishme sigurimi dhe rritja e cilësisë arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për t'u përshtatur më mirë me mjedisin e ardhshëm të punës, e parashikuar në Planin Strategjik 2024-2028.</p> <p>Për të arritur këtë synim, institucioni ka planifikuar bashkëpunim ndërmjet departamenteve për ofrimin e lëndëve, duke kombinuar leksionet, praktikën mësimore dhe punën praktike në mënyrë të koordinuar. Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme. Realizon trajnime për personelin akademik me qëllim përmirësimin e metodave didaktike. Kjo ndërhyrje synon të sigurojë që stafi pedagogjik të jetë sa më i përgatitur dhe i përshtatshëm për të mbështetur objektivat formuese, nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p><b>[Evidenca nr. 79 Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2023]</b></p>														
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Me anë të formave të përdorura për shpjegimin e koncepteve dhe dhënien e njohurive si dhe me format e kontrollit të dijeve mundësohet një mësimdhënie interactive dhe nxitet të menduarit kritik tek studentët. Tabela vijuese jep të dhëna mbi kualifikimin e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <table border="1" data-bbox="635 1619 1342 1926"> <thead> <tr> <th colspan="3">Stafi akademik për programin e studimit Bsc në Shkencave Islame</th> </tr> <tr> <th rowspan="2">Titulli/Grada</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc.</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Stafi akademik për programin e studimit Bsc në Shkencave Islame			Titulli/Grada	2023-2024		PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	Prof.Asoc.	2	-
Stafi akademik për programin e studimit Bsc në Shkencave Islame															
Titulli/Grada	2023-2024														
	PAE	PAK													
Prof.Dr	-	-													
Prof.Asoc.	2	-													

marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë mes tyre.	Dr	4	-
	Msc	7	3
	<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>3</b>
	<p>Zhvillimi i teknologjisë i ka sjellë më afër marrëdhënien pedagog student. Me ane metodave të mësimdhënies dhe të teknologjisë krijohet një marrëdhënie efektive dhe respekti ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, gjë që u konfirmua edhe nga studentët gjatë vizitës në institucion.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies edhe studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik.</p> <p>Instrumenti që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri. Pyetësori aktivizohet në sistemin BIS para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Studentët plotësojnë pyetësorët, ku pyeten për performancën e lektorëve, si dhe metodat apo format që secili pedagog aplikon gjatë lëndës së tij. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe siguron ruajtjen e anonimatit të studentëve gjatë realizimit të anketimeve. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse institucionit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme.</p> <p><b>[Evidenca nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët]</b></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie. Rregullorja e NjSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve</p>		






të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	të kryera nga studentët dhe vlerësimin të bërë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë.  [Evidenca nr. 18 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë  Evidenca nr. 40 Vendim i senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]								
<b>Konkluzione</b>	<i>Instrumenti që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësi i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri.  Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Studentët informohen nga një tërësi burimesh informimi mbi kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive. Fillimisht atyre u vjen në ndihmë Guida e Studentët, ku pasqyrohen rregulloret dhe mekanizmat e vlerësimit. Ky dokument u vihet atyre në dispozicion online, por edhe fizikisht, si pjesë e kontratës së studentit me institucionin. Kriteret e vlerësimit pasqyrohen gjithashtu qartazi në thujtë të gjitha dokumentet dhe rregulloret e institucionit. Procesi i vlerësimit përfshin elementë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësia e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lënda në lëndë.  [Evidenca nr. 43 Guida e Studentit, Rregullorja themelore, Rregullorja e Fakultetit, etj.]

<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen në fillim të çdo semestri për silabuset e lëndëve që do të ndjekin. Ata njihen me kërkesat dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga studentët gjatë gjithë kohës së semestrit, duke përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit për këto detyrime. Informimi bëhet nëpërmjet sistemit elektronik të studentit, në mënyrë të personalizuar.</p> <p><i>[Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga këqyrja e silabusesve, nga diskutimet me pedagogët dhe me studentët, rezulton se pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për testimin e aftësive të përftuara nga studentët. Kontrolli i njohurive përfshin provime të ndërmjetme, projekte, detyra kursi, punë në grup, raste studimore, provime finale, etj.</p> <p>Kjo qasje ndaj testimit të njohurive të studentëve u jep mundësi atyre jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë e përftuara, por edhe njohjen me forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njohurive dhe aftësive, zhvillimin e aftësive të punës në grup, të komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të aftësive prezantuese, analizuese, vlerësuese, si dhe aftësinë për të dhënë rekomandime për përmirësimin e situatave të caktuara.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç përmendet edhe më lart, studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies së pedagogëve nëpërmjet sondazheve dhe vlerësimit periodik, në fund të çdo semestri. TË dhënat/përfundimet nga pyetësorët i paraqiten me transparencë pedagogëve, në funksion të përmirësimit të performancës së tyre.</p> <p><i>[Evidenca nr. 75 Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit,</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, rezulton se nxitet dhe promovohet shumë puna në grup dhe projektet për të inkurajuar autonominë e punës së studentëve.</p> <p>Pedagogët në këto raste luajnë rolin e udhëheqësve akademikë, duke lehtësuar proceset e komunikimit dhe të shkrimit/prezantimit të projekteve.</p>



objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>[Evidenca nr. 42 Guida e stafit]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritur të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</i></p> <p><i>Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të larmishme.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Institucioni zbaton formën e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve të programit. Ky shtrihet përgjatë gjithë semestrit akademik. Për lëndë të posaçme, edhe gjatë gjithë vitit akademik, kur lënda është me dy semestra.</p> <p>Gjatë semestrit përcaktohen paraprakisht dy periudha kohore (java e tetë dhe ajo e fundit) kur zhvillohen provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, si dhe forma e tyre e cila pasqyrohet në çdo silabus.</p> <p>Vlerësimi i lëndës bëhet sipas rregulloreve përkatëse si dhe modaliteteve të përcaktuara për lëndën në silabusin e saj.u</p>



	<b>[Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni ka sistemin e brendshëm online BIS, ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Gjithashtu, mund të aplikohen teste me forma elektronike, të cilat rrisin transparencën dhe eliminojnë forma të ndryshme abuzimi. Kjo realizohet nëpërmjet formave të testimeve në platformën G-Suite.  <b>GVJ ju vu në dispozicion një ilustrim i sistemit me një rast konkret të simuluar.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Pedagogu i lëndës është përgjegjës për vlerësimin përfundimtar të lëndës. Ai bazohet në silabusin e paraqitur paraprakisht. Në raste specifike, pedagogu mund t'ia kalojë këtë përgjegjësi asistentit të tij. Prezantimet e punimeve realizohen para një komisioni të ngritur nga këshilli i departamentit. u
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët i shpallin rezultatet në platformën online dhe ofrojnë komente të mjaftueshme për studentët, shoqëruar shpeshherë edhe me çelësat e zgjidhjeve të tezave të provimit.  Pedagogët ofrojnë gatishmërinë e tyre të sqarojnë studentët për pikët/notën e marrë.
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni nëpërmjet Rregullores për disiplinën e studentëve, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Personeli akademik përgjegjës për punime të ndryshme detyrash dhe tezash, bën kontrollet e duhura të plagjiaturës me anë të platformave të vëna në dispozicion nga institucioni.  <b>[Evidenca nr. 53 Rregullorja për disiplinën e studentëve.</b>  <b>Evidenca nr. 81 Platforma digjitale për kontrollin e plagjiaturës/</b>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe	Nga vizita në institucion e GVJ dhe intervistat me studentët, rezultoi se përfundimet e provimeve dhe formave të tjera të kontrollit të dijeve bëhen në kohë të disponueshme për studentët, në përputhje me rregulloren institucionale prej 10-14

jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	ditësh nga përfundimi i testimit, në përputhje me rregulloren e institucionit.			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtën e studentit për të rishikuar vlerësimin, në përputhje me procedurat e Statutit. Studenti ka të drejtë që brenda një jave nga dalja e rezultatit në sistemin online të paraqesë një ankesë me shkrim në Sekretarinë Mësimore. Departamenti me vendim të Këshillit të tij ngre një komision me tre anëtarë, ku nuk mund të përfshihet pedagogu i lëndës. Teza/provimi/procesi rishikohet dhe rivlerësohet dhe rezultati i bëhet i ditur studentit jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës. GVJ ju vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion një praktikë e tillë.			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	[Evidence nr. 54 Procedurë ankimimi] [Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Ky Program Studimi Bachelor u ofron studentëve njohuri, dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Krahas njohurive shkencore-teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet praktikave.  Lëndët e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> zhvillohen duke u dhënë rëndësinë e duhur teorisë, seminareve,

	<p>projekteve, rasteve studimore dhe po ashtu praktikave profesionale. Nëpërmjet marrëveshjeve me organizata dhe shoqata të ndryshme në vend, institucioni u siguron studentëve praktika profesionale cilësore. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtëkurrikulare, siç janë: forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore, etj.</p> <p><b>[Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi përdor masivisht literaturë bashkëkohore të studimeve të fesë islame duke iu referuar burimeve online dhe librarive online. Ai garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e studimeve bashkëkohore të feve, gjë e cila vërtetohet edhe nëpërmjet literaturës mbështetëse është literaturë e huaj të ofruar në departament.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë e përfuara nga studenti analizohen në përfundim të lëndës përmes provimeve, përmes vlerësimit të lëndës dhe përditësimit të saj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirë përcaktuara në programet lëndore. Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e përfuara gjatë përgjatë leksioneve. Departamenti ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar “Bedër” me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.</p> <p>Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të fushës si Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, KNFSH, medresetë, institucione dhe organizma ndërkombëtare, që</p>




<p>caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>operojnë në fushën e studimeve të feve, me qëllim realizimin e programit.</p> <p>Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunime të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të departamentit. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e Programit. Rregullorja mbi kërkimin shkencor përcakton mënyrën e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve kompetente dhe kërkuesve shkencorë, duke përfshirë revistat shkencore, konferencat, projektet kërkimore, publikimet individuale dhe veprimtarinë kërkimore të studentëve, nëpërmjet procedurave që zbatohen.</p> <p><b>Evidenca nr. 50 Rregullorja mbi kërkimin shkencor</b></p> <p><b>Evidenca nr. 74 Lista e institucioneve me të cilat KU Bedër ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti e përfshin personelin akademik në orë të hapura dhe seminare, konferenca shkencore dhe workshop-e si dhe në kuadër të vizitave akademike në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+ ose projekteve të tjera. Kjo pasqyrohet nga departamenti në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><b>Evidenca nr. 64 Plani i aktiviteteve te departamentit</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</i></p> <p><i>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</i></p> <p><i>Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>





**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Diplomimi është një proces që rregullohet përmes rregulloreve dhe procedurave të miratuara nga institucioni. Ai është pjesë e Rregullores themelore të institucionit, Rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, Rregullores së programit, ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përbushë studentit deri në finalizimin e diplomimit të tij. Udhëzimi për shkrimin e tezës është publikuar në faqen e institucionit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë studentët.</p> <p><b>Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</b></p> <p><b>Evidenca nr. 66 Formular Vlerësimi i Tezës Bachelor</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Institucioni bën publik informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së diplomave në përputhje me Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë. Këshilltarët akademikë dhe udhëheqësit e diplomave kanë rol kyç në përcjelljen e informacioneve, udhëzimeve dhe materialeve të nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Gjithashtu, krahas Manualit për përgatitjen e punimit të diplomës, gjendet dhe Formulari i vlerësimit të tezës, ku gjenden dhe kriteret e vlerësimit të temës së diplomës për studentët e ciklit të parë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bërja e një punimi të detyrueshëm të tezës nga ana e studentit, në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, prezantimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i tezës përfshihet si lëndë e semestrit të dytë në programin mësimor. Mbrojtja e diplomës kryhet në praninë e një komisioni, i cili bën vlerësimin përkatës.</p> <p><b>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në</p>	<p>Këshilltari akademik, po ashtu edhe udhëheqësi i diplomës ka rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi. Në fillim të semestrit të dytë, secili student që ka të drejtë të marrë temën e tezës dhe propozon të punojë</p>






<p>përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron ta kryejë atë. Gjatë kësaj periudhe, studentët marrin prej udhëheqësit të gjitha udhëzimet, mbështetjen, orientimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të punës së tyre kërkimore-shkencore. Udhëheqësi akademik siguron cilësinë e punimit të diplomës duke miratuar ose refuzuar dorëzimin e këtij punimi pranë zyrës përkatëse në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti, përmes stafit të përcaktuar nga koordinatori i programit, angazhon dhe asiston studentët në kryerjen e matjeve dhe analizave, sidomos për punimin e diplomës, por edhe gjatë zhvillimit të eseve kërkimore.</p> <p><b>Evidenca nr. 73 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të tij në këtë program, studenti vlerësohet me notë për PPP ose për mbrojtjen e diplomës. GVJ-së ju vunë në dispozicion disa modele punimesh diplomash dhe praktikat e vlerësimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>[Minutat e vizitës në KUB]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pas plotësimit të të gjitha kriterëve të parashikuara në rregullore, pasi studentët plotësojnë 180 ECTS, pajisen me diplomën dhe suplementin e saj, si dhe një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit që kanë ndjekur.</p> <p><b>Evidenca nr. 45 Diplomë bachelor dhe suplementin i diplomës</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Arkivës, rezulton se institucioni pas diplomimit e depozicion të gjithë dokumentacionin e studentit në zyrat e arkivës.</p>

të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Studentët kanë të drejtën t'i drejtohen Arkivës me kërkesa për vërtetime për qëllime të ndryshme.  <b>Evidenca nr. 59 Rregullorja e Arkivës</b> <b>Evidenca nr. 26 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës.</i> <i>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë</i> <i>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin	Nga shqyrtimi që GVJ i bëri dokumentacionit përkatës, nga vlerësimi i dosjeve dhe të dhënave mbi arsimimin dhe kualifikimin e stafit të programit, rezulton se angazhimi i tyre është në përputhshmëri me detyrat e objektivat e programit, duke përmbushur kërkesat ligjore në fuqi. Personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit rezulton të ketë fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi, veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies. Gjithashtu stafi akademik, me arsimimin e kualifikimet që ka, ka realizuar, si risi, zhvillimin e programit "Bachelor" ne

e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

“Shkenca Islame” në gjuhën angleze, me një auditor të ndërkombëtarizuar studentësh, duke filluar nga viti akademik 2021-2022 e në vazhdim. Stafit, veç përvojës akademike, sjell në auditore edhe ekspertizë si hartues tekstesh, komentues, vlerësues apo përkthyes të veprave fetare, përvojë në veprimtari kërkimore-shkencore, etj që i kanë shërbyer në tërësi cilësisë së mësimdhënies. Institucioni zhvillon edhe trajnime për kualifikimin në vazhdimësi të personelit, që lidhen me realizimin e objektivave strategjike të institucionit dhe në funksion të realizimit të programit të studimit.

Në këtë program studimi, referuar, të dhënave për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	1	-	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	6	2	4	1	4	-
Msc.	7	2	9	2	7	3
<b>Totali</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>15</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	<b>3</b>

*[Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin; Ev.79: Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2023 Ev.19: Sylabuset e lëndëve të programit; Ev.64: Plani i aktiviteteve të departamentit; Ev.79: Lista e trajnimeve të stafit akademik]*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se personeli akademik që mbulon programin “Bachelor” në “Shkenca Islame” mbulon ngarkesën mësimore për programin në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore, duke realizuar 75% të orëve në auditor. Stafit i programit është si me poshtë

Institucioni ka hartuar edhe udhëzues për politika të përmirësimit të cilësisë së programit dhe performances se personelit akademik të programit, që përfshijnë zhvillimin profesional të pedagogëve, mundësinë e lëvizshmërisë të stafit jashtë për të sjellë përvojën më të mirë ndërkombëtare, motivim të personelit akademik për kërkim shkencor e inovacion,

	<p>vlerësim të mësimdhënies dhe lëndës me tregues të posaçëm, etj.</p> <p><i>[RVB, Shtojca. Tab. Permbi; Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.20: Udhëzim për ngarkesën mësimore; Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin; Ev.36: Raporti i Departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni e ka të dëshmuar dhe të garantuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit për të gjithë periudhën e akreditimit. Kjo u evidentua edhe nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku anetaret e Grupit u njohën me dosjet e personelit akademik që mbulon programin e që përmbajnë dokumentacionin e plotë, bashkë me kontratat e punësimit e të dhënat mbi sigurimet shoqërore e shëndetësore.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.42: Guida e stafit; Ev.63: Lista e të dhënave të dosjes së stafit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se për rekrutimin e përzgjedhjen e personelit, institucioni ka një procedurë të përcaktuar në dokumentin “Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit”. Në nenet përkatëse të kësaj rregulloreje përcaktohen kriteret e procedurës së rekrutimit të stafit, të drejtat e detyrat e personelit akademik, promovimi i karrierës së stafit akademik, etj. Gjithashtu, institucioni aplikon një procedurë e rregullt e transparente për punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe atë administrativ.</p> <p>Evidentimi i kërkesës për personel akademik realizohet nga Departamenti, i cili përcjell nevojat specifike për lëndë të caktuara në Dekanat dhe prej këtej, për miratim Rektorit. Kërkesa e miratuar i dërgohet për ndjekje Zyrës së Burimeve Njerëzore, që publikon vendin vakant në në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose zyrës së punës. Sipas informacionit nga takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, institucioni ndjek politika të rekrutimit të stafit edhe nga të diplomuarit e vetë institucionit; për këtë qëllim studentë të programit të ciklit të dytë bëjnë praktikën pranë kësaj zyre, për punësimin e tyre në të ardhmen në njësitë administrative të</p>




	<p>institucionit (aktualisht, janë disa të punësuarit e kësaj kategorije).</p> <p>Rregulloret përkatëse të organizimit akademik dhe atij administrativ përcaktojnë detyrat dhe funksionet e organeve akademike si dhe kushtet e punësimit, përgjegjësitë dhe kompetencat e stafit administrativ. Kontrata e punës mund të jetë me afat dhe/ose pa-afat, në bazë të kategorisë së stafit akademik dhe kohës së punësimit të tij pranë KUB, në përputhje me rregulloren. Po kështu, të drejtat e detyrat sipas kategorisë së punës për stafin akademik janë të gjitha të përcaktuara qartë në dokumentat e mësipërme (statut e rregullore), bazuar në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë. Procesi i vlerësimit, qoftë institucional , ashtu edhe i vetëvlerësimit që rezultojnë se aplikohen në mënyrë sistematike, janë indikatorë të tjerë që tregojnë nivelin e zbatimit të të drejtave, detyrave e përgjegjësiave të stafit akademik në institucion.</p> <p><i>[Minutat e vizites;Ev.12:Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit; Ev.14: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës e nga njohja e dosjeve të personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezulton se Departamenti i Shkencave Islame, në përputhje me nevojat specifike, angazhon, gjatë procesit të zhvillimit të programit mësimor, personel me kualifikim akademik si “asistent-lektorë”, pranë titullarëve të lëndëve. Për vetë specifikën e tij, programi “Bachelor” në “Shkenca Islame”, që përmban kryesisht leksione dhe seminare të integruara, nuk aplikon orë të mirëfillta laboratorike.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev. 16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit</p>	<p>KU “Beder” zotëron një bazë të dhënash të personelit, të cilat përditësohen çdo vit akademik me të dhënat e reja të veprimtarisë mësimore e shkencore të gjithsecilit. Nga biseda e</p>



<p>akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>informimi i GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore mbi dosjet e personelit të angazhuar në programin e studimit, konkludohet se procedura e mbledhjes dhe ruajtjes të të dhënave të personelit akademik kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Bazuar në rregulloren përkatëse të institucionit, me nenet e detajuara mbi mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e sigurimin e të dhënave personale, janë përcaktuar të gjitha procedurat organizative e teknike si dhe masat përkatëse për këtë qëllim e po ashtu edhe masat administrative në rast shkeljeje. Në fillim të semestrit, me propozim të departamentit, aprovohet sipas procedurës përkatëse ngarkesa mësimore për çdo anëtar të stafit akademik, që përfshihet në të dhënat e përditësuara të secilit.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.69: Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e sigurimin e të dhënave personale]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar nga takimet që GVJ realizoi me stafin e studentët e programit “Bachelor” në “Shkenca Islame” si dhe në njësitë administrative përkatëse, u konstatua se janë nënshkruar, lidhur me realizimin e praktikave profesionale, marrëveshje bashkëpunimi me KMSH dhe shkollat e mesme (Medresetë), KNFSH, Prizmi si dhe me institucione të tjera fetare dhe biznese. Konstatohet se departamenti i kushton rëndësi bashkëpunimit me institucionet, jo vetëm për mundësinë e zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, por edhe për perspektivën e punësimit të studentëve pas diplomimit. Për realizimin e marrëveshjeve për praktikat profesionale është përgjegjëse Zyra e Planifikimit të Karrierës. Në bashkëpunim edhe me Dekanatin e studentëve, kjo njësi organizon edhe një sërë veprimtarish njohëse e promovuese, në funksion të përgatitjes e aksesit të studentëve në tregun e punës.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.60: Raport i Zyrës së Planifikimit të karrierës; Ev.38: Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale; Ev.76: Marrëveshjet me medresetë; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave</p>	<p>Mbi bazën e marrëveshjeve me institucionet pritëse për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, personeli mbikëqyrës i tyre asiston studentët në përmbushjen e detyrimeve e raportit përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në</p>

profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	procesin e vlerësimit të tyre për performancën, gjatë zhvillimit të kësaj praktike.  <i>[RVB; Ev.41: Rregullore e praktikës profesionale]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri dokumentacionit përkatës rezulton se personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit ka fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi, veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita e GVJ në KUB dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë e godinës, rezulton se institucioni disponon një mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Në tërësi, këto mjedise fizike dhe të pajisura me mjetet e nevojshme u shërbejnë objektivave të formimit teorik, praktik dhe profesional të studentëve. Institucioni ka sallat e leksioneve, të seminareve, salla për aktivitete promovuese, salla për praktika lëndore/profesionale, laboratorë lëndësh, laboratorë informatike, salla interneti, salle biblioteke, mjedise për fotokopje, mjedis sportiv, zyrë informacioni për studentët, mjedise për veprimtari të qeverisë studentore, mjedise shlodhëse etj. Me një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mirëpajisur, ato vihen në dispozicion, në përputhje me numrin e studentëve e natyrën specifike të programit të studimit.  <i>[Minutat e vizitës; Ev.10: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa,	Nga vizita në institucion rezulton se hapësirat e mjedisve (klasave, zyrave, sallës së kompjuterave, bibliotekës) dhe

<p>laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>pajisja e tyre me elementët e nevojshëm (kompjuter, projektor, dërrasë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike etj), nisur edhe nga numri i vogël i studentëve si dhe specifika e departamentit, përgjithësisht janë të mjaftueshme dhe efikase për realizimin e programit të studimit. Mjediset janë të reja, të mirëmbajtura, ndërsa kondicionimi e ndriçimi i duhur japin komoditet dhe i shërbejnë efikasitetit të procesit mësimdhënës.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.10: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelierët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi “Bachelor” në “Shkencat Islame” nuk është i natyrës teknike për të patur nevojë për laboratorë eksperimentalë. Sidoqoftë, kërkesat e moduleve të lëndëve në përmbajtje të programit plotësohen në mjediset e vëna në dispozicion nga institucioni, të pajisura me infrastrukturën e teknologjinë e duhur mësimore didaktike, internet, kompjutera, smartboard, etj.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.10: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka siguruar dy laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale, sipas specifikës së programeve të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.10: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita e GVJ në KUB dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë e godinës, rezulton se institucioni disponon një mjedis fizik dhe infrastrukturë të pajisur me mjetet e nevojshme, që u shërbejnë objektivave të formimit teorik, praktik dhe profesional të studentëve, të mjaftueshme dhe efikase për realizimin e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse e programit “Bachelor” në “Shkenca Islame” është në gjuhën angleze; nga vizita e GVJ në bibliotekën mësimore të institucionit e biseda me pedagogët e studentët e programit, rezulton se biblioteka, me fondin fizik që disponon si dhe me shërbimin online, ve në dispozicion botime, tekste mësimore, literaturë ndihmëse, monografi dhe revista shkencore në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera, si turke dhe arabe, si dhe literaturë në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, konsiderohet i nevojshëm zgjerimi i mëtejshëm i fondit të bibliotekës me botime, vecanërisht në gjuhën anglisht, por edhe në shqip. Biblioteka disponon një literaturë të zgjeruar edhe në fushat e shkencave të tjera shoqërore, si të sociologjisë, filozofisë, psikologjisë së fesë, pedagogjisë etj, që u mundëson studentëve të plotësojnë e zgjerojnë njohuritë përkatëse e të ndërthurura me ato të Shkencave Islame.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.82:Të dhëna të plota për platformën on-line. Biblioteka; Ev. 57: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës; Ev. 36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njëسيا përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se KU “Beder” parashikon fonde për blerje të literaturës së specializuar, sipas profilit të departamentit përkatës. Në buxhetin vjetor të Departamentit të Shkencave Islame figurojnë edhe një zë i titulluar “Shpenzime për literaturën e re”, ku parashikohet një fond i caktuar për përditësimin e literaturës me botime e publikime të viteve të fundit, në funksion të programeve të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.77: Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Salla e bibliotekës ze një hapësirë prej 120 m<sup>2</sup> dhe ofron 24 poste leximi. Ajo është e pajisur me 8 kompjutera, ofron shërbimin online si dhe mundëson akses për studentët gjatë aktivitetit universitar, duke garantuar mundësi të barabarta të shfrytëzimit të saj nga studentët e programit të studimit. Në “Guidën e Studentit” jepen informacione të hollësishme lidhur me bibliotekën e institucionit, shërbimin, faqen online të saj, funksionimin e hapësirat e shfrytëzimit të JSTOR.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB-tab.17; Ev.43:Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në bibliotekë e dokumentacioni mbi të, rezulton se fondi fizik i saj është i përbërë nga një numër i konsiderueshëm tituj shkencorë, libra e monografi shkencore, revista e materiale të tjera në gjuhë të huaj edhe shqip për plotësimin e nevojave të moduleve dhe veprimtarive mësimore të programit me tekste e literaturë ndihmëse. Sipas përgjegjëses së bibliotekës, ka një interes e frekuentim të vazhdueshëm nga ana e studentëve si përgjatë procesit akademik në kryerjen e detyrimeve të lëndëve, seminareve, detyrave të kursit etj, ashtu edhe realizimit të temave të diplomave apo pjesmarrjes së studentëve në aktivitete kërkimore-shkencore. Sidoqoftë, siç vihet në dukje nga analiza SWOT në raportin vjetor të Departamentit të Shkencave Islame, nevojitet shtimi i mëtejshëm i literaturës mësimore në anglisht edhe shqip.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KU “Beder” ka marrëveshje me kontratë të rinovueshme vjetore për akses të plotë të stafit dhe studentëve në bibliotekën dixhitale JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë me anë të email-it institucional, duke patur kështu në dispozicion burime të shumta studimore në funksion të fushës së programit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.44: Marrëveshja për akses në JSTOR; Ev.82: Të dhëna të plota për platformën on-line... biblioteka online]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike</p>	<p>Biblioteka e insitucionit është e pajisur me programe kompjuterike dhe ka në përdorim 8 kompjutera që u japin mundësi studentëve t’i përdorin ato pa kufizim; database e</p>






<p>dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>biblotekës gjëndet gjithashtu online, çka i ndihmon ata në gjetjen e literaturës së nevojshme.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Mjediset e bibliotekës janë të disponueshme nga ora 8.30 deri në orën 19.00 të mbrëmjes. Orari është afishuar në hyrje të bibliotekës. Në sezonin e provimeve, biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë. Në bazë të sistemit të automatizimit, institucioni u ka dhënë mundësi studentëve që kërkesën për sigurimin e literaturës dhe regjistrimin ta bëjnë në formë elektronike. Nëpërmjet bibliotekës online JSTOR në të cilën institucioni është abonuar, ofrohet sigurimi i materialeve e literaturës edhe në rrugë elektronike, duke patur akses në punime të shumta akademike, libra dhe material të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Shfrytëzimi i bibliotekës është i lidhur ngushtë me rritjen e cilësisë e kërkesës së stafit akademik në drejtim të përdorimit të literaturës, detyrave e punimeve shkencore të studentëve në lëndët përkatëse të programit. Nga vizita e GVJ në bibliotekën e institucionit e biseda me përgjegjësen e saj, konstatohet se janë të dokumentuara të dhënat e përdorimit të fondit fizik dhe online të bibliotekës, si nga stafi, ashtu edhe nga studentët. Sipas përgjegjëses së bibliotekës, ka një interes të vazhduar e në rritje të shfrytëzimit të materialeve të fondit fizik dhe online, në kushtet edhe të mundësive që institucioni u ka dhënë departamenteve për pasurimin e literaturës, sipas profilit të programeve, me botimet dhe publikimet më të fundit. Pedagogët e Departamentit të Shkencave Islame bëjnë përditësimin e titujve e teksteve sipas fushës përkatëse, me qëllim reflektimin e debatit akademik bashkëkohor.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB; Ev.1:Mendimi i Dekanit]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita e GVJ në bibliotekën mësimore të institucionit e biseda me përgjegjësen e bibliotekës, rezulton se në dispozicion të studentëve është vënë një fond fizik dhe dixhital me një</i></p>



	numër të konsiderueshëm botimesh, tekstesh mësimore e literaturë ndihmëse në gjuhën angleze si gjuha e programit, por edhe në gjuhë të tjera që lidhen me të. Synohet zgjerimi i mëtejshëm i botimeve në anglisht dhe shqip në fushën e Shkencave Islame.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Sipas dokumentacionit, sistemi i automatizuar që përdoret në KU "Beder" është Sistemi Informativ BIS Beder. Në dokumentin e institucionit "Udhëzues i sistemit informativ" pasqyrohet qartë funksionimi i tij, që mundëson që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre: të dhënat personale; programi, e-mail, data e regjistrimit, gjuhët, arsimimi i mëparshëm, statusi i regjistrimit të lëndëve, statusi i komunikimit me bibliotekën, të dhënat që lidhen me diplomimin, etj. Zyra e teknologjisë së informacionit e institucionit u shërben studentëve për çështje të IT që ata kanë nevojë e që lidhen edhe me përdorimin e hollësishëm dhe efektiv të sistemit informativ BIS.</p> <p><i>[Ev.43: Guida e studentit; Ev.35: Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve	Në sistemin informativ BIS, të gjitha njësitë kanë llogarinë apo faqen e tyre, ku bëjnë veprimet që lidhen me profilin e punës përkatëse. Në BIS kanë llogarinë e tyre studentët e sekretaria studentore, stafi akademik, burimet njerëzore (me zëra si: informacione të përgjithshme për punëmarrësit, informacione akademike, emërimet, publikimet dhe aktivitete të stafit, përditësime të personelit, etj), biblioteka, sekretaria e departamentit (me zëra si: kurrikula, menaxhimi




<p>të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>i lëndëve, lëndët aktive), këshilltari akademik me listën e studentëve dhe të lëndëve, financa, zyra e pranimit, etj.</p> <p><i>[Ev.35: Udhëzues i sistemit informativ BIS; Ev.82: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi informativ BIS, ku njësitë e institucionit, personeli e studentët kanë llogarinë e tyre përkatëse, mundëson në këtë mënyrë akses në dokumente e informacione për të gjithë stafin dhe studentët e programit “Bachelor” në “Shkenca Islame”. Zyra e IT e institucionit asiston për të gjitha çështjet teknike që lidhen me funksionimin e cilësinë e sistemit BIS.</p> <p><i>[Ev.35: Udhëzues i sistemit informativ BIS; Ev.42: Guida e stafit; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për vetë strukturën e tij, sistemi informativ BIS mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit midis personelit akademik dhe studentëve. Bëhet i mundur, psh, komunikimi me këshilltarin akademik, pedagogun/asistentin përkatës, sekretarinë studentore për çështje administrative etj, duke ofruar, në të gjitha rastet, të dhëna të përditësuara. Në “Guidën e studentit” dhe “Guidën e stafit” jepen informacionet e duhura lidhur me përdorimin e platformave online.</p> <p><i>[RVB-tab.17; Ev.42: Guida e stafit; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se sistemi informativ BIS Beder garanton në kohë reale monitorim të veprimtarisë akademike dhe administrative, duke lehtësuar punën në institucion e duke garantuar korrektësi, mbi bazën e të gjitha udhëzimeve e procedurave që dalin nga senati dhe rektorati. Ky sistem jep mundësi, si për studentët edhe për stafi akademik, të monitorohet në kohë reale pjesmarrja në mësim, nota, të dhënat e studentit, të lëndëve, etj.</p> <p><i>[Ev.82: Të dhëna të plota për platformën online]</i></p>




<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KU “Beder”, në faqen e tij zyrtare në internet <a href="http://beder.edu.al">beder.edu.al</a>, të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera, i ka të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Edhe informacionet që lidhen me Departamentin e Shkencave Islame gjenden në adresën <a href="http://www.isc.beder.edu.al">www.isc.beder.edu.al</a>.</p> <p><i>[RVB; Ev.82: Të dhëna të plota për platformën online]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Sistemi i automatizuar që përdoret në KU “Beder” është Sistemi Informativ BIS Beder. Nëpërmjet tij, administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Gjithashtu, në sistemin informativ BIS, të gjitha njësitë akademike dhe administrative kanë llogarinë apo faqen e tyre, ku mundësohen veprimet e proceset që lidhen me profilin e punës së tyre..</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës e sipas RVB, institucioni harton raport vjetor financiar të kostove të njësisë bazë e të detajuara sipas zërave që mbështetin, nga pikëpamja buxhetore, mbarëvajtjen e programeve të studimit me shpenzimet dhe të ardhurat përkatëse.</p> <p>KU “Beder” gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Sipas statutit, ai mbështetet në kapitalin e themeluesit e pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij, donacione të ndryshme, të ardhura të ndryshme të krijuara e burime të tjera të ligjshme financiare. Projekt-buxheti hartohet në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm trevjeçar dhe propozimet nga strukturat përkatëse. Lidhur me programin “Bachelor” në “Shkenca Islame”, nevojat buxhetore të tij përfshihen në projekt-</p>







	<p>buxhetin e detajuar, që aprovohet nga mbledhja e Këshillit të Departamentit të Shkencave Islame.</p> <p><i>[Ev.2: “Statuti i KU “Beder”; Ev.77: Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame; Ev. 83: “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi të ardhurat dhe financimet e institucionit për periudhën e fundit trevjeçare, konstatohen ndarjet sipas zërave përkatës, si grantet për kërkim e kontratat, konsulencat e shërbimet, tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacionet, etj. I detajuar në zëra e shifra përkatëse është edhe projekt-buxheti i hartuar nga njësi bazë në funksion të realizimit të programeve dhe që lidhet me shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve e teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, për bibliotekën e pasurimin e fondit të saj, për aktivitetet studentore, për konferenca, për qëllime promovimi e marketingu, etj</p> <p><i>[Ev.77: Buxheti I Departamentit të Shkencave Islame; Ev. 83: “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas statutit të KUB, Bordi i Administrimit ka si përgjegjësi garantimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, ndërsa Administratori i Kolegjit është përfaqësuesi ligjor për mirëfunksionimin financiar të tij; në përfundim të çdo viti akademik ai i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit akademik, raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit.</p> <p>Në njësinë përgjegjëse, në rolin e administruesit dhe kontrollorit të veprimtarisë financiare të fakultetit është administratori përkatës. Në planin strategjik të institucionit, ndër objektivat që lidhen me politikën dhe burimet financiare është theksuar sigurimi i standarteve të larta të përgjegjësisë, integritetit dhe kontrollit financiar, përditësimi i strategjive</p>





	<p>financiare afatshkurtra dhe afatmesme, duke vlerësuar periodikisht stabilitetin financiar.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare. Sipas statutit, institucioni i nënshtrohet edhe auditimit të jashtëm, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave.</p> <p><b>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.8: Plani Strategjik Institucional i KU “Beder” 2024-2028; RVB-tab.18]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB, fondacioni, pjesë e të cilit është KU “Beder”, harton raportet financiare sipas legjislacionit në fuqi, brenda afateve të përcaktuara dhe me pasqyra të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve. KU “Beder” i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo fund viti akademik raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projekt-buxheti i vitit të ardhshëm akademik si edhe projekt-buxheti afatmesëm.</p> <p><b>[RVB; Ev.83: “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion e biseda me drejtuesit e njësisë përgjegjëse e njësisë bazë si dhe bazuar në RVB, rezulton se KU “Beder” ka tashmë një përvojë mbi dhjetëvjeçare të funksionimit të tij si IAL jofitimprurëse, ku ka dëshmuar qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe mbështetje të donatorëve për ecurinë normale të programeve. Aktiviteti financiar i institucionit, kriteret e shpërndarjes së burimeve financiare e menaxhimi i tyre, realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”, ligjin nr.8788, dt 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, ligjin nr.9224, dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, në Standartet Kombëtare të raportimit financiar, etj.</p> <p><b>[Minutat e vizitës; RVB]</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU “Beder” gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës.</i></p> <p><i>Projekt-buxheti hartohet në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm trevjeçar dhe</i></p>




	<i>propozimet nga strukturat përkatëse. Lidhur me programin "Bachelor" në "Shkenca Islame", nevojat buxhetore të tij përfshihen në projekt-buxhetin e detajuar perkates, që aprovohet nga mbledhja e Këshillit të Departamentit të Shkencave Islame.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në bazë të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", KU "Beder", bazuar në Statutin dhe Rregulloret e brendshme, zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plote akademik të studentëve, nga hyrja në dalje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin "Bachelor" në "Shkenca Islame", GVJ konstaton se programi, në të gjithë ecurinë, mbështetet në një sërë aktesh rregullatore institucionale, që u përgjigjen kërkesave të zhvillimit të tij, sipas objektivave përkatës.  <i>[Ev.2: Statuti I KU "Beder"; Rregullorja themelore e KU "Beder"; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Ev.6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor" në "Shkenca Islame"]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për	Në faqen zyrtare të KU "Beder" bëhen publike, për çdo vit akademik, kriteret e pranimit të studentëve të programit "Bachelor" në "Shkenca Islame", në kushte të barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë. Përveç rregullores bazë të


<p>të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>institucionit, është hartuar edhe rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë si dhe rregullorja e posaçme e programit “Bachelor” në “Shkenca Islame”, që zhvillohet në gjuhën angleze. Në nenet përkatëse të tyre, evidentohen qartazi kriteret e pranimit të studentëve, kompetencat e nevojshme të zotërimit të gjuhës së huaj, vlerësimi i pranimit, njohja e krediteve të nevojshme, procedura e regjistrimit dhe organizimi i procesit mësimor, kushtet e transferimeve nga IAL të tjera, statusi i studentit e shumë çështje të tjera që lidhen me të gjithë procesin e zhvillimit të programit, të njëjta për të gjithë studentët. Përveç informacionit nga institucioni, të interesuarit për programet e ciklit të parë mund të marrin të dhëna e të ndjekin procedura regjistrimi dhe aplikimi edhe nëpërmjet portalit U-Albania.</p> <p><i>[Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.70: Politika e KU “Bedër” për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit e biseda me drejtuesit e njësisë përgjegjëse e bazë ku ofrohet programi “Bachelor” në “Shkenca Islame”, rezulton se institucioni publikon çdo vit akademik kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për programin. Si procedurë, institucioni i dërgon Ministrisë së Arsimit kuotat përkatëse dhe kriteret, ndërsa i bën ato publike edhe në faqen zyrtare të internetit. Sipas rregullores së programit, kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%.</p> <p>Në rregulloren përkatëse të programit të studimit përcaktohen edhe kriteret e tjera që lidhen me specifikën e programit: kandidatët që aplikojnë për pranim në programin që zhvillohet në gjuhë të huaj duhet të kenë marrë një ndër provimet e përcaktuara nga Senati dhe duhet të dorëzojnë certifikatat përkatëse ose vërtetimin e provimit të mjaftueshmërisë të gjuhës së programit të organizuar nga departamenti, përpara se të fillojë procesi mësimor. Kandidatët që kanë kryer një cikël të plotë studimi në gjuhën e programit të studimit dhe e kanë përfunduar me sukses atë si dhe kandidatët që janë folës amëtarë të gjuhës përkatëse të programit nuk është e nevojshme paraqitja e një dëshmie të tillë. Studentët shpallen fitues në portalin U-Albania dhe përcillen zyrtarisht pranë Kolegjit Universitar “Bedër”. Pas këtij momenti studentit i lind</p>



	<p>e drejta të lidhë kontratën e arsimimit me Kolegjin Universitar “Beder”. Si praktikë, institucioni bashkëpunon me drejtoritë arsimore rajonale dhe, nëpërmjet panairove të karrierës që organizon në qytete të ndryshme, prezanton programet e studimit.</p> <p><b>[Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nëpërmjet faqes zyrtare të KU “Beder” mund të merret, në mënyrë të plotë e të qartë, i gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e procedurat e pranimit të studentëve e të dhëna të tjera që u referohen programeve të studimit që ofrohen. Njësitë kryesore, por edhe ato bazë që ofrojnë programet, kanë faqet e tyre të internetit, me informacione të nevojshme lidhur me kurrikulat, sylabuset e lëndëve, personelin akademik përkatës, etj. Studentët mund të marrin çdo informacion të hollësishëm mbi programin për të cilin janë të interesuar edhe pranë Zyrës së pranimit të studentëve apo sekretarisë së departamentit që ofron programin.</p> <p><b>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.43: Guida e Studentit]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet se institucioni, përmes faqes së internetit, panairove të arsimit dhe karrierës, broshurave e takimeve të drejtpërdrejta, bën të njohur ofertën vjetore të programeve që ofron, bashkë me tarifën e studimit e kriteret e pranimit. Si një institucion jofitimprurës, KU “Beder” ndjek politika pranimi që përputhen me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore që ka në dispozicion.</p> <p><b>[RVB; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe</p>	<p>Institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara. Në “Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë” ka një nen të posaçëm mbi studentët me aftësi të veçanta, ku garantohet arsimimi i tyre si pjesë integrale e sistemit arsimor. Sipas këtij neni, mosdiskriminimi i studentëve me aftësi të veçanta dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë</p>



<p>shtresave të marginalizuara.</p>	<p>konsiderohet një ndër parimet prioritare të KU “Bedër”. Gjithashtu, institucioni ka marrë masa për lehtësimin e studentëve të kësaj kategorie edhe nga pikëpamja e infrastrukturës e shërbimeve mbështetëse për ta.</p> <p><b>[RVB, Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në “Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë” si dhe “Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Islame” parashikohet pranimi i studentëve të huaj, duke plotësuar kërkesat e procedurës së regjistrimit, në përputhje me rregulloren. Këto kritere bëhen publike përpara çdo viti akademik në faqen zyrtare të institucionit. Për vetë natyrën e tij unike dhe faktin që ofrohet në gjuhën angleze, programi “Bachelor” në “Shkenca Islame” ka përthithur, në të tri vitet e ciklit, një numër në rritje .studentësh të huaj.</p> <p>2021-2022 8 studente te huaj , 2 shqiptar; 2022-2023 5 studente te huaj , 2 shqiptar; 2023-2024 6 studente te huaj , 4 shqiptar;</p> <p><b>[Minutat e vizitës; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame”]</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika të veçanta që lidhen me ofrim bursash për studentët e programeve të ciklit të parë të studimeve; vec bursave të ekselencës e të talentit, aplikohet edhe programi i Bursave sociale. Për kategoritë e përcaktuara të studentëve si me status jetimi, pa kujdestari prindërore, me pamundësi ekonomike, me prindër të rënë në detyrë, me status invalidi, paraplegjiku, tetraplegjiku, ofrohet deri 100% bursë.</p> <p><b>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder; RVB]</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU “Beder” ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Si një institucion jofitimprurës, KU “Beder” pranon një numër të caktuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore që zotëron, duke zbatuar edhe një politikë mbështetëse për personat me aftësi të veçanta, pakicat e shtresat e marginalizuara. Në KU “Beder,</i></p>





	<i>bazuar në rregulloren përkatëse, publikohen dhe aplikohen çdo vit akademik edhe kriteret për pranimin e studentëve të huaj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Rregulloret e posaçme të institucionit lidhur me programin “Bachelor” në “Shkenca Islame” apo dokumenti “Guida e studentit”, ofrojnë një informacion të plotë dhe të hollësishëm lidhur me të gjitha procedurat e ecursë akademike të studentëve. Edhe sekretaria mësimore, si njësi administrative institucionale, ka për detyrë dhënien e çdo informacioni të kërkuar nga studentët, që lidhet me aspekte të ndryshme të ecursë e përparimit të tyre gjatë procesit mësimor. Nga ana tjetër, departamenti cakton një person përgjegjës, në rolin e këshilltarit akademik, për t’iu përgjigjur të gjitha nevojave për sqarime të studentëve e mbështetjes së tyre për probleme e vështirësi që mund të ndeshen gjatë procesit akademik.</p> <p><i>[Ev.43: Guida e studentit; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	<p>Në Rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” janë përcaktuar qartë kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesëshme. Nenet e rregullores parashikojnë kushtet mbi plotësimin e njohurive formuese para hyrjes në program, mbi njohjen e krediteve për njohuritë e fituara më parë, etj.</p> <p>Një rregullore e posaçme e institucionit lidhur me transferimin e studimeve qartëson në mënyrë të hollësishme kriteret e këtij procesi, si të transferimit të studentëve nga IAL të tjera apo brenda Kolegjit, mbi bazë kuotash të përcaktuara. Departamenti ngre një komision të posaçëm, me tre anëtarë, për gjykimin e vlerësimin e përmbushjes së kriteve.</p>

	<p><i>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame; Ev.25: Rregullorja e transferimit të studimeve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në një sërë dokumentesh të hartuara nga institucioni, si: Rregullorja themelore e tij, Guida e studentit, Rregullorja e programit të studimit etj, janë përcaktuar qartësisht e në mënyrë të hollësishme kriteret e vlerësimit të dijeve të studentit, kriteret e kalimit në vitin pasardhës, e përmirësimit të mesatares së përgjithshme, kushtet e provimit e riprovimit, etj. Nga ana tjetër, sqarimi mbi kriteret e procedurat e vlerësimit u bëhet i njohur studentëve që në javën e parë të prezantimit të lëndëve nga pedagogët përkatës. Gjithashtu, sylabuset e lëndëve përmbajnë kriteret e vlerësimit, ndërsa në sistemin BIS studenti ka të dokumentuar rezultatet në procesin mësimor, pikët e fituara e notat e lëndëve, mesataren etj.</p> <p><i>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame; Ev.43: Guida e studentit; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” pasqyrohen kriteret dhe procedurat lidhur me punimin e diplomës dhe diplomimit. Në nenet e saj thuhet se studentët e programit të ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome; punimi i diplomes përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor. Po në rregullore përcaktohet se bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit, në përputhje me programin e arsimit dhe që tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike, që përcaktojnë edhe kushtet e kryerjes së punimit, afatin e dorëzimit dhe vlerësimin e punimit. Për aftësimin e studentit për kërkim shkencor dhe në funksion të përgatitjes së diplomës, në këtë program studimi të ciklit të parë është parashikuar si lëndë e detyrueshme formimi i përgjithshëm “Metodat e kërkimit”, ku jepen njohuri bazë mbi metodat e avancuara të kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame; Ev.19: Sylabuset e lëndëve të programit;</i></p>



	<b>Ev.73: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë]</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Nga biseda në institucion dhe njohja e dokumentacionit, rezulton se KU "Beder" dhe në veçanti Departamenti i Shkencave Islame që ofron programin "Bachelor" në "Shkenca Islame", e kanë patur si objektiv të përhershëm informimin dhe publikimin e të dhënave për programin për të gjithë të interesuarit e studentët. Nëpërmjet takimeve të hapura, panairove të organizuara për këtë qëllim, broshurave e katalogëve të publikuar në faqet zyrtare, në mënyrë periodike bëhen të njohura të gjitha programet e ofruara, përmbajtja e tyre, diplomat e fituara dhe rëndësia e aksesit në tregun e punës.</p> <p>Për realizimin e këtyre aktiviteteve njohëse, institucioni mbështetet edhe në bashkëpunimin me drejtoritë arsimore rajonale.</p> <p><b>[Minutat e Vizitës; Ev.68: Programi i diteve të orientimit; RVB]</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit "Bachelor" në "Shkenca Islame", ashtu si edhe programet e tjera të KU "Beder", bëhet publik nëpërmjet veprimtarive të hapura informuese, takimeve, panairove, broshurave e katalogëve të posaçëm, përmes faqeve zyrtare të internetit, por edhe nëpërmjet praktikës së bashkëpunimit me drejtoritë arsimore rajonale</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Në "Ditët e Orientimit", që KU "Beder" organizon në javën e parë të fillimit të vitit të ri akademik, studentët njihen me personelin akademik dhe administrativ, me këshilltarët akademikë dhe marrin informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Personeli akademik, në detyrën e këshilltarit akademik, sipas udhëzuesit të posaçëm të miratuar nga institucioni dhe</p>

	<p>rregullores së organizimit akademik, ka të përcaktuara një sërë detyrash në ndihmë të studentëve, për mbarëvajtje të suksesshme gjatë procesit mësimor. Informacionet mbi programet janë të aksesueshme edhe në sistemin BIS e faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>[Ev.49: Udhëzues i Këshilltarit Akademik; Ev.3: Rregullorja mbi organizimi akademik; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në mbështetje të studentëve, institucioni ka hartuar “Guidën e Studentit”, një udhëzues që u ofron atyre informacion të hollësishëm mbi procedurat e veprimtarisë mësimore. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit BIS, studentët informohen për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca Islame” përcakton parimet e funksionimit të programit, organizimin e studimeve, strukturën e planit mësimor sipas tipit të veprimtarive, me lëndët/modulet e kreditet përkatëse.</p> <p><i>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Islame; Ev.43: Guida e Studentit ]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në KU “Beder” janë ngritur struktura të posaçme në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës. Zyra e planifikimit të karrierës, pranë Drejtorisë së marrëdhënieve me studentin., funksionon në ndihmë të studentëve për t’i ndihmuar ata në orientimin dhe këshillimin e karrierës. Ajo mundëson praktikant profesionale të studentëve, sipas programeve e profileve të tyre, dhe ndjek nga afër procesin.</p> <p>Pranë saj, cdo department cakton këshilltarin për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Ai i informon ata mbi teknikat e kërkimit të punës, shkrimin të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake, kërkon mundësi punësimi për studentët e diplomuar, organizon aktivitete që synojnë ruajtjen e marrëdhënieve me studentët pas diplomimit. Gjithashtu, pranë departamenteve funksionon edhe Bordi i këshillimit të karrierës, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre, që u mundëson studentëve lidhjet me tregun e punës. Marrëveshjet e institucionit me organizata e biznese të ndryshme i shërbejnë jo vetëm zhvillimit të praktikave mësimore, por edhe mundësisë së punësimit të studentëve pas diplomimit.</p>






	<i>[Minutat e Vizitës; RVB; Ev.24: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame; Ev.47: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e përfaqësuesit të karrierës]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni u ve studentëve në dispozicion informacion të detajuar e të përditësuar mbi zhvillimin e organizimin e studimeve. Në “Ditët e Orientimit” dhe në “Guidën e Studentit” sqarohen çështje që lidhen me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën e shërbimet që ofrohen në institucion, etj. Gjithashtu, në fillim të semestrit, pedagogu përkatës bën të njohur përmbajtjen e tematikën e lëndës që do zhvillojë e që përmbahet në programin e studimeve, detyrimet e studentëve e kërkesat e tjera të lidhura me zhvillimin e procesit mësimor.  <i>[Ev.43: Guida e Studentit; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni ka ndërtuar një platformë të konsoliduar online, që i shërben procesit mësimor. Sipas RVB, studentët e KU “Beder” janë të informuar në kohë reale lidhur me programin e studimit përmes sistemit BIS (Beder Information System), i cili është i lidhur me llogarinë personale të studentit: <a href="mailto:gmail@beder.edu.al">gmail@beder.edu.al</a> . Në institucion funksionon edhe Zyra e IT, që është në dispozicion të studentëve për cdo nevojë e problematikë të aksesit të tyre në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Komunikimi dhe informimi i studentëve kryhet edhe nëpërmjet sekretarive, pranë njësisë kryesore e asaj bazë.  <i>[RVB; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.82: Të dhëna të plota për platformën online; Ev.35: Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>KU “Beder” ve në dispozicion të studentëve një informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit e mundësitë e punësimit nepermjet “Guidës se Studentit”, “Ditëve te Orientimit”, sistemit BIS e faqes zyrtare të institucionit si dhe strukturave të posaçme te tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e biseda e GVJ në Zyrën e sekretarisë mësimore, njohja me regjistrin bazë e mënyrën e plotësimit të tij, rezulton se procesi i regjistrimit të studentëve në programin e ciklit të parë “Bachelor”, mbajtja e statistikave të tyre e të studentëve të diplomuar, kryhet në përputhje me procedurat përkatëse, sipas rregullores. Zyra krijon dosjen personale dhe elektronike për çdo student, mban statistika të rregullta dhe, në mënyrë periodike, raporton mbi to në fund të çdo semestri. Zyra ka si detyrim jo vetëm përfshirjen e dokumentacionit të studentit në sistemin e menaxhimit të informacionit, por edhe përditësimin e këtij informacioni. Të gjitha procedurat që kryhen në Zyrën e sekretarisë mësimore bazohen në rregulloren e saj, ku përshkruhen me hollësi rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ mori të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi:</p> <p>2021-2022 10 studente; 2022-2023 7 studente; 2023-2024 10 studente;</p> <p><i>Minutat e Vizitës; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga njohja e GVJ me dokumentacionin në Zyrën e sekretarisë mësimore rezulton se ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, në procedurat që kryen, zyra ka edhe detyrimin për të dokumentuar rastet kur studenti mund të tërhiqet nga programi që ndjek, të largohet para përfundimit të tij, apo të mos e përfundojë me sukses vitin akademik. Këto të dhëna statistikore raportohen pranë njësisë përgjegjëse institucionale.</p>

	<i>[Minutat e Vizitës; Ev.21: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve që lidhen me procesin mësimor në KU “Beder” menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit BIS, i aksesueshëm nga personat përgjegjës të sekretarisë mësimore dhe këshilltari akademik, në kuadër të kompetencave që ai ka. Gjithashtu, Rregullorja e Zyrës së sekretarisë mësimore parashikon, në përpunimin e të dhënave personale të studentëve, ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.  <i>[Minutat e vizites; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e njësive përbërëse administrative. Nëpërmjet auditimeve të brendshme, vlerësohet dokumentacioni dhe saktësia e informacionit që lidhet me studentët. Këto auditime, të realizuara nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, synojnë evidentimin e kontrollin e zbatimin të ligjshmërisë për çështjet sa më sipër Ato bazohen në rregulloret përkatëse të institucionit dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i shërbejnë sigurimit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme në njësitë përbërëse të tij.  <i>[Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.51: Procedura për Auditimin periodik të brendshëm]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës dhe nga biseda me drejtuesin e njësisë bazë që mbulon programin “Bachelor” në “Shkenca Islame”, konstatohet se njësia harton raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të saj.  <i>[Minutat e Vizitës; Ev.21: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i>

<b>Konkluzione</b>	<i>Nëpërmjet Zyrës së sekretarisë mësimore pranë institucionit, në përputhje me rregulloren, mbliidhen, administrohen, ruhen dhe përditësohen të dhënat statistikore të studentëve. Njësia kryesore dhe ajo bazë hartojnë raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të programeve të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në statutin e KU “Beder”, studentët kanë të drejtë të kenë këshillat e tyre studentore (në nivel kolegji e fakulteti), nëpërmjet të cilave ata mbështeten në të gjitha aspektet e jetës studentore e përfaqësohen pranë institucionit e autoriteteve të tjera në nivel kombëtar. Këshillat shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit apo fakultetit përkatës për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për tarifrat e shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Ndërkaq, institucioni mbështet këshillat dhe financon veprimtaritë e tyre nga fondi i posaçëm i buxhetit të tij vjetor.</p> <p>Në Rregulloren themelore të institucionit, parashikohen kompetencat e Dekanatit të studentëve. Sipas këtij dokumenti, Dekani i studentëve është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin; ai koordinon aktivitetet social-kulturore të tyre dhe kryen detyrat në bashkëpunim me organet drejtuese. Dekani angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me jetën universitare, në koordinimin mes njësive akademike dhe administrative për çështje që prekin interes të studentëve, vlerëson e drejton aplikimet akademike, sociale, profesionale dhe administrative lidhur me jetën në mjediset universitare,</p>

	<p>kryen veprimtari ne shërbim të rritjes së cilësisë së jetesës së studentëve e të aktiviteteve sociale të tyre. Sipas Ligjit të arsimit të lartë, studentët janë përfshirë gjithashtu në senatin akademik të institucionit, tek NJSBC dhe në Komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë. Me vendim të senatit Akademik, KU “Beder” i ka përfshirë studentët në këshillin e fakultetit dhe në këshillin e departamentit.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.39: Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në këshillin e departamentit dhe në këshillat e fakulteteve]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga biseda e GVJ në departamentin e Shkencave Islame me studentët e programit “Bachelor” ne “Shkenca Islame” si dhe nga dokumentacioni përkatës, rezulton se studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit akademik në forma të ndryshme, si nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave të njësisë kryesore dhe bazë, në NJSBC, në grupet e punës gjatë procesit të akreditimit apo në vlerësimin e veprimtarisë së institucionit dhe punës së stafit akademik.</p> <p>Anketa studentore që vlerëson cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni, me nje sere zerash perkates per kete qellim, zhvillohet një herë në çdo vit akademik; kohën e kryerjes e përcakton NJSBC e institucionit. Dy herë në vit, përpara provimeve të fundit të çdo semestri, studentët plotësojnë anketat vlerësuese për zhvillimin e lëndëve dhe performancën e pedagogut, bazuar në rregulloren e posaçme të institucionit mbi anketat e vlerësimit. Në to jepen gjykime lidhur me realizimin e objektivave dhe tematikave të programit të lëndës, literaturën, ngarkesën e metodologjinë e lëndës, cilësinë e mësimdhënies, motivimin e vlerësimit nga ana e pedagogut, etj.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.30: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve; Ev.32: Ankete vlerësimi e studenteve ndaj institucionit; Ev.33: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>Nëpërmjet pjesëmarrjes në këshillat studentore, sipas statutit të KU “Beder”, mundësohet përfshirja e studentëve, me mendime e propozime, në procesin e vlerësimit të planeve e programeve të studimit e hapjen e programeve të reja, në përmirësimin e rregulloreve e veprimtarisë mësimore. Nga ana tjetër,</p>





<p>përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>pjesmarrja në mbledhjet e departamentit u krijon studentëve hapësirë për vlerësime dhe sugjerime të drejtpërdrejta lidhur me aspekte të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.2: Statuti i KU "Beder"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me studentët e programit "Bachelor" në "Shkenca Islame", rezultoi se njësia bazë, në mënyrë koherente, u krijon atyre mundësinë për të dhënë mendime e propozime mbi korrektësinë e stafit akademik në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve dhe, në përgjithësi, mbi integritetin e realizimit të procesit mësimor. Studentët vlerësuan se, si nga drejtuesit e departamentit, ashtu edhe nga ana e stafit akademik, ka gatishmëri e përgjegjësi për të reflektuar në raste ankimimesh.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.33: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU "Beder", bazuar në akte ligjore e nënligjore e udhëzime të posaçme, përfshin dhe angazhon studentët në organe vendimarrëse e këshilluese, duke realizuar pjesëmarrjen e tyre në procesin e vlerësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre nga ana e institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë të KU "Beder", njësia kryesore shpall publikisht programet e akredituara që ofron para fillimit të pranimeve. Në</p>






<p>informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>faqen zyrtare të internetit publikohet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi përmbajtjen e tyre. "Guida e studentit" është një udhëzues i plotë në shërbim të informimit të studentëve, ndërsa brenda institucionit funksionojnë për këtë qëllim njësitë e posaçme administrative, si zyra e sekretarisë mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>Nga ana tjetër, sipas rregullores themelore të institucionit, Dekani i studentëve ka, në statusin e tij të posaçëm, përgjegjësinë për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Ai angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve lidhur me jetën universitare, në koordinimin mes njërive akademike dhe administrative për çështje që prekin interesat e studentëve, etj.</p> <p><i>[Ev.6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të institucionit e RVB, në KU "Beder" funksionon një sistem eficient për informimin, këshillimin, ndjekjen e asistimin e studentëve përgjatë procesit mësimor. Takimet informuese, trajnimet apo udhëzuesit për stafin e studentët i shërbejnë drejtpërdrejt këtij qëllimi. Me vendim të posaçëm të senatit akademik të institucionit është miratuar udhëzuesi i këshilltarit akademik, i cili caktohet nga departamenti dhe është në dispozicion të studentëve për informimin dhe orientimin e tyre lidhur me programin, kurrikulën, personelin dhe infrastrukturën në dispozicion, mbi kriteret e kalimit në vitin pasardhës, sezonin e kushtet e riprovimeve, transferimet, etj. Koordinator i departamentit për programet e ciklit të parë ndjek ecurinë e procesit mësimor, oraret e lëndëve e provimeve, procesin e mbrojtjes së diplomes, etj, duke realizuar edhe komunikimin me njësinë bazë, personelin akademik dhe studentët për problematikat që kanë të bëjnë me ecurinë e programit të studimit. Institucioni i informon studentët edhe në lidhje me procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p><i>[RVB; Ev.49: Udhëzues i Këshilltarit Akademik; Ev. 48: Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programeit Bachelor; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren themelore të institucionit lidhur me këshillimin e karrierës, funksionon, pranë Dekanatit të studentëve, Zyra e planifikimit të karrierës, pranë së cilës cdo department emeron këshilltarin e planifikimit të karrierës, që ofron këshillim për studentët e regjistruar. Në kompetencat e këshilltarit të karrierës hyjnë informimi i studentëve mbi organizimin e seminareve, teknikave të aplikimit për punë, mënyrës së hartimit të CV dhe kalimit me sukses të intervistës së punës. Gjithashtu, këshilltari i karrierës kërkon mundësi punësimi për të gjithë studentët e diplomuar dhe organizon aktivitete që i shërbejnë ruajtjes së marrëdhënieve me studentët, pas diplomimit të tyre. Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura, të ftuarve e seminareve profesionale, studentëve u krijohet mundësia të informohen hollësisht për mundësitë e punësimit, pas mbarimit të programit të ciklit të dytë. Nga takimi i GVJ me përfaqesues të Zyres së planifikimit të karrierës rezultojnë se kjo njësi, në bashkëpunim me departamentin, mundëson dhe ndjek nga afër edhe procesin e praktikave profesionale të studentëve. Gjithashtu, pranë departamentit funksionon edhe Bordi i këshillimit të karrierës, me anëtarë profesionistë e aktivë në profesionin e tyre; bordi u mundëson studentëve lidhjen me tregun e punës.</p> <p><i>[Minutat e vizites; Ev.5:Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.47: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës; Ev. 36: Raporti vjetor I Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe sipas dokumentacionit përkatës, rezultojnë se KU “Beder” ka në strukturën e vet administrative zyrën e të diplomuarve, që funksionon në varësi të Dekanatit të studentëve. Zyra ruan e përpunon të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve, duke i vënë ato në dispozicion të organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Zyra e karrierës dhe zyra e të diplomuarve, si njësi institucionale administrative, hartojnë raporte periodike mbi punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, mundësitë e tregut etj, duke i vënë këto të dhëna në dispozicion qoftë të studentëve, ashtu edhe të organeve drejtuese të institucionit.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; RVB; Ev.58: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame; Ev.60: Raport i Zyrës së Planifikimit të Karrierës]</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>KU "Beder" ka hartuar politika dhe procedura si dhe ka në dispozicion njësi të posaçme institucionale për pritjen, orientimin dhe menaxhimin e ankimimeve e problematikave të studenteve përgjatë zhvillimit të programeve të studimit si dhe për këshillimin e karrieres e lidhjen me tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Institucioni i ka kushtuar rëndësi proceseve vetë vlerësuese, me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në funksion të kësaj ka ndërtuar disa hallka.</p> <p>Së pari, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me kompetencë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e cilësisë.</p> <p>Këto akte ia dërgon Senatit Akademik, i cili po ashtu është një aktor i rëndësishëm në vlerësimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Krahas këtyre, funksionojnë dy komisionet e përhershme. Institucioni ka ndërtuar edhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, të cilat përfshijnë elementë të vlerësimit, angazhimit të studentëve, trajtimit gjithëpërfshirës e të barabartë, etj.</p> <p><b>Evidenca nr. 15 Udhëzim për metodat e mësimdhënies</b></p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Në çdo semestër organizohen anketa me studentët për vlerësimin e stafit dhe lëndës. Gjithashtu stafi plotëson një formular vetëvlerësimi në fund të së cilit bëhet dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit për çdo lektor. Stafit akademik vlerësohet edhe me anë të formularit për vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Gjithashtu bëhet edhe një vlerësim në nivel departamenti dhe fakulteti. Për stafin e ri, në momentet e rekrutimit por pas leksionit të hapur, bëhet dhe një vlerësim nga komisioni përkatës.</p> <p><b>[Evidenca nr. 61 Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik</b></p> <p><b>Evidenca nr. 75 Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Garantimi i përfshirjes së studentëve nga institucioni bëhet përmes anketave dhe vlerësimeve për personelin.</p> <p>Në varësi të rezultateve, Departamenti bazohet në diskutimet me pedagogët gjatë performancës vjetore.</p> <p>Anketat me studentët zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri. E drejta e ankimit është parashikuar në <i>Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë</i>, neni 36, dhe u ofron të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë mundësinë e ankimit.</p> <p>Anketimet e studentëve për personelin akademik plotësohen përmes sistemit BIS para zhvillimit të provimeve finale në çdo fund semestri. Plotësimi i pyetësorëve është anonim dhe përgjigjet përpunohen në mënyrë automatike e të pavarur .</p> <p><b>Evidenca nr. 71 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</b></p> <p><b>Evidenca nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë bëhen publike në të gjitha format që ofron institucioni.</p>






bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<b>Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. Bazuar në rezultatet e dala nga vlerësimet e personelit akademik, institucioni ka shpallur listën e stafit me performancën më të lartë për të dy fakultetet e tij.</p> <p>Gjithashtu, prej vitesh njësia bazë konsultohet edhe me bashkëpunëtorët e jashtëm, duke përfshirë edhe lektorët me kohë të pjesshme, të cilët po ashtu kontribuojnë me sugjerime mbi zbatimin e programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</i></p> <p><i>Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	<p>Për të garantuar cilësi institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të përbërë nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët një (1) kryetar, dy (2) janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore (një për çdo fakultet), një (1) përfaqësues i këshillit studentor dhe një (1) ekspert i jashtëm. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Po ashtu, institucioni ka ngritur dy komisione të përhershme të cilat janë të parashikuara në Statut. Mënyra e organizimit dhe</p>



<p>aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>e funksionimit të tyre është përcaktuar me rregullore të veçanta. Komisionet janë: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit dhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin. Këto komisione vlerësojnë periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Janë hartuar Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe Politika e Përmirësimit të Programeve të studimit.</p> <p><b>Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC</b></p> <p><b>Evidenca nr. 18 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë</b></p> <p><b>Evidenca nr. 11 Politika e Cilësisë</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Në të dyja këto struktura administrative krahas anëtarëve të tjerë janë të përfshirë edhe përfaqësues të këshillit studentor, i cili zgjidhet nga studentët dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p><b>Evidenca nr. 78 Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor instrumente dhe tregues të cilësisë, të jashtëm dhe të brendshëm. Ai ka kaluar përmes tre proceseve akreditimi institucional, në vitin 2013 nga APAAL, në vitin 2017 nga agjencia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL, si dhe së fundmi nga ASCAL.</p> <p><b>Evidenca nr. 80 Marrëveshja e bashkëpunimit me “Educators without Borders</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të</p>	<p>Institucioni përdor tregues të qartë dhe të matshëm, vlerësime paralele të provimeve (të paparalajmëruara) apo detyrave të</p>




matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	studentëve, vizita në auditorë (nga përfaqësuesit e Departamentit përkatës ose të Dekanatit), apo testime të standardizuara.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	<p>Ky institucion përdor disa forma dhe mekanizma formalë, si mbledhjet, takimet vjetore, raportet vjetore, ku parashikohen edhe arritjet, dobësitë dhe plani i përmirësimit. RVJ ju vunë në dispozicion disa praktika mbledhjesh dhe raportesh.</p> <p>Në procedurën e ndryshimit të kurrikulave, përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, studentët, madje edhe të diplomuarit me qëllim që të adresohen në mënyrë të saktë të gjitha problematikat me të cilat mund të jetë përballur një program studimi. Rezultatet e vlerësimeve arkivohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përkatëse që janë përgjegjëse për vendimmarrje, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 13 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>





<p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><b>Evidenca nr. 65 Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës</b></p> <p><b>Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm shoqërohen me plane veprimi ku parashikohen rezultatet e vlerësimit, masat që do të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë dhe rezultatet e pritshme.</p> <p>Në këto plane veprimi gjithashtu caktohen njësitë përgjegjëse për ndjekjen e çështjes dhe periudha kohore e zbatimit. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit (studentë, personel akademik dhe administrativ) në faqen e internetit të tij.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. Gjithashtu, rishtazi është miratuar Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm, i cili përfshin elemente, si: silabusi, metodat e mësimdhënies, llojet e vlerësimit të detyrave dhe projekteve, etj.</p> <p><b>Evidenca nr. 31 Formulari i vlerësimit për stafin akademik</b></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, e cila plotësohet në fund të çdo semestri dhe studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe lëndën. Në të përfshihen aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxëniet, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj.</li> <li>2) Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit ku vlerësohen të gjitha shërbimet e ofruara dhe merren edhe rekomandime nga studentët për këto shërbime.</li> <li>3) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit, ku merret vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara</li> <li>4) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit administrativ ndaj institucionit, ku merren vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara në institucion.</li> <li>5) Anketa me studentët e programit të studimit. Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve merren masa për përmirësimin e shërbimeve dhe programit të studimit.</li> </ol>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</i></p> <p><i>Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në strukturat e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit ka aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të NjsBC-së ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm.</p> <p><b>Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, stafin akademik dhe administrativ, studentët dhe palë të tjera, të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit janë të përcaktuara nga institucioni në rregulloret përkatëse. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p> <p><b>Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Në analizat vjetore mbi mbarëvajtjen e institucionit, marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit, duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ. Ata shkëmbejnë përvojat e tyre dhe japin rekomandime në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>Institucioni garanton që përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.</p> <p>Institucioni synon krijon një mjedis arsimimi dhe pune studimore-kërkimore, duke përjashtuar çdo lloj diskriminimi. Kjo zbatohet për të gjithë personelin dhe studentët. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe kryesisht Senati akademik e ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit</p>






pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik.  <b>Evidenca nr. 42 Guida e stafit</b>								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni përfshin në sigurimin e cilësisë aktorë të jashtëm nëpërmjet strukturave përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë. Komisioni i Përhershëm dhe NjsBC-ja kanë në përbërjen e tyre një anëtar/ekspert të jashtëm. Institucioni organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka garantuar në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.</i>  <i>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit është garantuar përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore.</i>  <i>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezulton se janë bërë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të	Të gjitha veprimtaritë e SBC-së janë publike në faqen e internetit të institucionit, si më poshtë: <a href="https://qac.beder.edu.al/">https://qac.beder.edu.al/</a> .

<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezulton se institucioni ka publikuar rezultatet e vlerësimeve të progmaimit të studimit.</p> <p>Publikimi ka respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin.</p> <p>Raportet e brendshme: <a href="https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem">https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem</a>.</p> <p>Raportet e jashtme: <a href="https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports">https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports</a></p> <p>Vendimet e BA <a href="https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions">https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga konstatimet e vlerësimeve dhe pas diskutimit të tyre edhe në njësitë bazë përkatëse në NjSBC, në komisionet e përhershme dhe në Senatin Akademik, ngrihen grupe pune për hartimin e plan veprimeve. Një shembull është planveprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor, i cili u finalizua me miratimin e disa akteve të rëndësishme nga Senati Akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Informacionet e marra nga pyetësorët e ndryshëm janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore respektive. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen te personeli akademik dhe diskutohen për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p>Varësisht rezultateve të vlerësimeve periodike të formave të ndryshme të vetëvlerësimit, bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim ose zhvillim të mëtejshëm, varësisht zyrave përkatëse dhe më pas riauditohet nga komisioni <i>ad-hoc</i>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni synon informimin në çdo kohë të stafit dhe të studentëve mbi cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>Për këtë arsye, vazhdimisht organizohen takime informuese, trajnime, si dhe u vihet në dispozicion Guida e stafit dhe Guida e studentit ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, NjSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre për përfshirje aktive në procesin e</p>




	<p>vlerësimin të brendshëm të programit me anë të plotësimin të anketave e formularëve përkatëse por edhe me anë të sugjerimeve. Këto janë të pasqyruara edhe në faqen e NjSBC-së: <a href="https://qac.beder.edu.al/activities">https://qac.beder.edu.al/activities</a></p> <p><b>Evidenca nr. 42 Guida e stafit</b></p> <p><b>Evidenca nr. 43 Guida e Studentit</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimin të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Islame” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Bedër”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit “Bachelor” në Shkenca islame është hartuar mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik institucional të qartë, të plotë dhe modern.
2. Ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze dhe është i vetmi program që ofron studime universitare në fushën e Shkencave islame në Shqipëri.
3. Përfshirja e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca islame në projekte të mbështetura nga BE, rasti i Erasmus+, etj.
4. Programi unik “Bachelor” në Shkenca islame mundëson një formim, që përmbledh në vetvete cilësitë dhe aftësitë e leximit dhe perceptimit të burimeve themelore të studimeve islame.
5. Nevoja për të diplomuar studentë në fushën e Shkencave islame të cilët mund të shërbejnë në Shqipëri, rajon dhe Perëndim, përforcohet nga synimi i qartë se krahas aspektit akademik, programi i jep rëndësi edhe ruajtjes së traditës shekullore shqiptare të Islamit autokton dhe bashkëpunues në trojet tona, si dhe një model edhe për Evropën multifetare.
6. Bashkëpunime me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione të tjera të fushës, me anë të së cilave realizon objektivat për praktikën, kërkimin shkencor, ndarjen e përvojave dhe punësimin e të diplomuarëve.
7. Një ndër bibliotekat më të pasura me literaturë fetare në Shqipëri, e cila është një mundësi e mirë për hulumtime shkencore në këtë fushë.
8. Mundësitë e punësimit në strukturat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH), Kolegjit Universitar “Bedër”, medreseve në Shqipëri, rajon, diasporë dhe më gjerë.

**Pika të dobëta:**

1. Sfidat e konsolidimit të programit për shkak të mungesës së eksperiencave të ngjashme në vend dhe rajon.
2. Pamundësia e rekrutimit të personelit akademik shqiptar si dhe atij ndërkombëtar për shkak të mosnjehsimit të diplomave me karakter teologjik të fituara jashtë Shqipërisë.
3. Pengesa e njehsimit të diplomave “Bachelor” me profil në studime teologjike jashtë Shqipërisë.
4. Sfida e studimeve të larta në *Shkencat islame* në një vend postkomunist dhe antiteist siç ka qenë Shqipëria, e cila ndodhet në rrugën pakthim të integritimit në BE.

**Rekomandime:**

1. Fuqizimi i mëtejshëm i studentëve në praktikat profesionale përmes shtimit të një lënde si Praktika Profesionale





2. Bazuar në vlerësimin e Standardit II.2, Kriteri 2, rezulton se ka vetëm një personel ndihmës akademik. Rekomandohet që të shtohet ky personel ndihmës akademik.
3. Konsolidimi i mëtejshëm i stafit akademik
4. Konsolidimi i mëtejshëm i cilësisë akademike.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Islamic Sciences" provided by the Higher Education Institution "Bedër"**

**Strengths and affirmations**

1. The Program embraces a clear strategic vision and mission for institutional development.
2. This Program is offered in English and is the only program that offers university studies in Islamic Sciences in Albania.
3. The Department and staff and students are well integrated into EU projects, such as Erasmus+
4. The need for students of Islamic Sciences in Albania and the region, based on the centuries-long Albanian Islamic Tradition and its promotion.
5. The students and lecturers can take advantage of a vast library with religious literature.
6. Possibility to get employed in the AMC structures, in the Institution, in the Madrasas and elsewhere in the region.

**Weaknesses**

1. Challenges of program consolidation due to the lack of similar experiences in Albania and the region.
2. Limited ability to academic staff recruitment due to the lack of degree recognition from the Albanian state.
3. Challenges emanating from the difficulties to recognize Bachelor degrees in theological studies outside Albania
4. Challenges coming to theologies studies in a country with a historical atheist past such as Albania.

**Recommendation**

1. Further empowerment of students through professional practice.
2. Further consolidation of the academic staff.
3. Further consolidation of the academic quality.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X